



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.106

9 gusht

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MPPTT nr.12, datë 19.7.2007	Për përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emetimin e licencave, bllokut të udhëtimit dhe regjistrimit të shërbimit taksi.....	3061
Udhëzim i MPPTT nr.13, datë 19.7.2007	Për një ndryshim në udhëzimin nr.370, datë 28.1.2004 “Për modelet e licencave, certifikatave dhe autorizimeve për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”.....	3067
Udhëzim i MPPTT nr.14, datë 19.7.2007	Për disa shtesa e ndryshime në udhëzimin nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”.....	3070
Udhëzim i MPPTT nr.15, datë 24.7.2007	Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor.....	3081

UDHËZIM
Nr.12, datë 19.7.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË AUTOVETURAVE TAKSI, SHTYPJEN DHE
EMETIMIN E LICENCAVE, BLOKUT TË UDHËTIMIT DHE REGJISTRIT TË
SHËRBIMIT TAKSI**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 36, nenit 37, nenit 38 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe pikës 1 të nenit 85 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit,

UDHËZON:

1. Kriter bazë në përcaktimin e numrit të përgjithshëm të licencave në shërbimin taksi, në të gjithë vendin, do të jetë autovetura me 4+1 vende dhe numri i popullatës së regjistruar, sipas regjistrit të gjendjes civile.

2. Numri i autoveturave të licencuara në shërbimin taksi për çdo bashki, përcaktohet sipas raportit 1 taksi me 4+1 vende për 1000 banorë. Ky numër nuk ndryshon.

3. Brenda numrit të përgjithshëm të autoveturave taksi të përcaktuar në pikën 2 më sipër lejohet deri në 50 % e këtij numri të konvertohet në autovetura taksi me 8+1 vende. Koeficienti i konvertimit është 2 (2 autovetura taksi, me 4+1 vende, janë të barasvlershme me 1 autoveturë taksi me 8+1 vende).

4. Këshilli bashkiak, në përputhje me politikat vendore të tij, mund të përcaktojë një kufi tjetër, më të ulët se 50% e numrit të përgjithshëm të autoveturave taksi me 4+1 vende, të cilat konvertohen me autovetura taksi 8+1 vende.

5. Zyrat e transportit në qark i shpërndajnë çdo bashkie kuotën bazë dhe rezervë, të numrit të licencave, që i përket, në përputhje me pikën 2 dhe aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Zyrat e transportit në qark dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila ia shpërndan drejtorive rajonale, listën me numrat e serisë së licencave, për taksitë, të cilat i janë vënë në dispozicion çdo bashkie.

7. Zyrat e transportit në bashki dërgojnë pranë drejtorive rajonale përkatëse, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, listën me emrat e subjekteve transportuese në shërbimin taksi, të përzgjedhur për t’u licencuar.

8. Zyrat e transportit në bashki dërgojnë, pranë degëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në rrethe, listën me emrat e subjekteve transportuese në shërbimin taksi, të përzgjedhur për t’u licencuar, për vendosjen, kolaudimin dhe plumbosjen e taksimetrit të shoqëruar me numrin e serisë për çdo subjekt.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) merr masat e nevojshme për kryerjen e veprimeve dhe lëshimin e aktit të vlerësimit për autoveturat taksi, në përputhje me udhëzimin nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, vetëm pasi subjekti është pajisur me taksimetër në gjendje pune sipas pikës 8 dhe emri i tij të jetë i përfshirë në pikën 7 më sipër.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të marrë të gjitha masat e nevojshme për shtypjen e kuotës bazë dhe rezervë të licencave të autoveturave në shërbimin taksi. Shpërndarja kryhet në bazë qarku, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Licencat në shërbimin taksi shtypen me numër serie dhe të jenë të pajisura me elemente sigurie, në mënyrë që të përjashtohet mundësia e kopjimit ose falsifikimit të tyre.

12. Përdorimi i kuotës rezervë të licencave kryhet në përputhje me udhëzimin nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

13. Drejtoria e Politikave të Transportit Rrugor të përgatisë modelin e bllokut të udhëtimit, i cili i lëshohet agjencive të transportit të udhëtarëve, dhe i cili përmban dokumentin e udhëtimit, për grup të prenotuar/rezervuar më parë, me të cilin duhet të pajisen autoveturat taksi gjatë udhëtimit.

14. Drejtoria e Politikave të Transportit Rrugor të përgatisë modelin e regjistrit të dokumentit të udhëtimit për shërbimin taksi, për grup të prenotuar/rezervuar më parë, me të cilin duhet të pajisen

agjencitë e transportit të udhëtarëve.

15. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) të shtyp dhe administrojë shpërndarjen e bllokut të udhëtimit dhe regjistrin të dokumentit të udhëtimit në përputhje me udhëzimin nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

16. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), të krijojë regjistrin kombëtar për subjektet në shërbimin taksi, brenda 60 ditëve nga dalja e këtij udhëzimi. Qëllimi i përdorimit të regjistrin kombëtar për subjektet taksi jepet në udhëzimin nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

ANEKSI 1

NR.	Emertimi i Qarkut, Kodi	KUOTA		Rrethi					Bashkia	Popullsia sipas gjendjes civile	Kuota sipas Bashkive	Kuota baze sipas bashkive ne rang rrethi	Kuota Rezerve per cdo Bashki
		Baze	Rezerve	Emertimi	Popullsia sipas gjendjes civile	Kuota baze	Nr. Serisë së Kuotës Bazë	Nr. Serisë së Kuotës Rezervë					
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	01 BERAT	239	48	Berat	154,297	154	BR 0001-0154	BR 10001-10030	Berat	63,801	64	130	25
				Kuçove	49,063	49	BR 2001-2049	BR 10031-10040	Kuçovë	12,000	12	24	5
				Skrapar	35,825	36	BR 3001-3036	BR 10041-10048	Çorovodë	30,337	30	49	10
2	02 DIBER	197	40	Diber	85,294	85	DI 0001-0085	DI 10001-10017	Peshkopi	8,432	8	17	4
				Bulqizë	43,955	44	DI 2001-20044	DI 10018-10026	Bulqizë	9,406	9	19	4
				Mat	68,364	68	DI 3001-3068	DI 10027-10040	Burrel	18,515	19	85	17
3	03 DURRES	393	78	Durres	313,600	314	DR 0001-0314	DR 10001-10063	Bulqizë	13,223	13	44	9
				Durres	313,600	314	DR 0001-0314	DR 10001-10063	Burrel	17,965	18	39	8
				Durres	313,600	314	DR 0001-0314	DR 10001-10063	Klos	12,820	13	29	6
3	03 DURRES	393	78	Durres	313,600	314	DR 0001-0314	DR 10001-10063	Durrës	194,747	195	254	50
				Durres	313,600	314	DR 0001-0314	DR 10001-10063	Manëz	8,939	9	12	3
				Durres	313,600	314	DR 0001-0314	DR 10001-10063	Sukth	24,109	24	31	6
3	03 DURRES	393	78	Durres	313,600	314	DR 0001-0314	DR 10001-10063	Shijak	12,778	13	17	4
				Durres	313,600	314	DR 0001-0314	DR 10001-10063	Krujë	15,737	16	32	6
				Durres	313,600	314	DR 0001-0314	DR 10001-10063	Fushë Krujë	23,188	23	45	9

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
4	04 ELBASAN	431	86	Elbasan	278,448	278	EL 0001-0278	EL 10001-10056	Elbasan	124,873	125	225	45
				Peqin	36,667	37	EL 2001-2037			14,642	15	27	6
				Gramsh	39,860	40	EL 3001-3040		Gramsh	13,904	14	26	5
				Librazhd	75,927	76	EL 4001-4076	EL 10072-10086	Librazhd	8,902	9	37	7
5	05 FIER	485	97							14,602	15	40	8
										9,954	10	42	8
									Përrenjas	8,248	8	34	7
				Fier	263,612	264	FR 0001-0264	FR 10001-10053	Fier	83,819	84	177	35
6	06 GJIROKAS TER	162	32	Lushnje	177,069	177	FR 2001-2177	FR 10054-10088	Patos	32,510	33	70	14
									Roskovec	8,481	8	17	4
				Mallakaster	43,542	44	FR 3001-3044	FR 10089-10097	Lushnje	54,799	55	143	28
				Gjirokaster	83,037	83	GJ 0001-0083	GJ 10001-10016	Divjakë	13,016	13	34	7
7	07 KUKES	114	23	Tepelene	42,015	42	GJ 2001-2042	GJ 10017-10024	Ballsh	11,915	12	44	9
									Gjirokastër	35,068	35	76	14
				Permet	36,765	37	GJ 3001-3037		Libohovë	3,176	3	7	2
									Tepelenë	8,208	8	22	4
8	08 DURRES	114	23	Permet	36,765	37	GJ 3001-3037	GJ 10025-10032	Memaliaj	7,399	7	20	4
									Përmet	10,812	11	25	5
				Kukes	63,195	63	KU 0001-0063	KU 10001-10012	Këlcyrë	5,035	5	12	3
				Tropoje	30,439	30	KU 2001-2030	KU 10013-10018	Kukës	21,406	22	63	12
9	09 SHKUTER	114	23	Has	21,414	21	KU 3001-3021	KU 10019-10023	Bajram Curri	8,699	9	30	6
									Krumë	7,783	8	21	5

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
8	08 KORÇE	355	71	Korçë	196,490	196	KO 0001-0196	KO 10001-10039	Korçë	86,065	86	183	36
									Maliq	6,215	6	13	3
				Kolonjë	26,802	27	KO 2001-2027	KO 10040-10045	Ersekë	10,093	10	21	4
				Devoll	42,210	42	KO 3001-3042	KO 10046-10053	Leskovik	2,765	3	6	2
				Pogradec	90,752	90	KO 4001-4090	KO 10054-10071	Bilisht	9,698	10	42	8
9	09 LEZHE	210	42	Lezhe	98,511	98	LE 0001-0098	LE 10001-10019	Pogradec	39,605	40	90	18
									Lezhë	25,943	26	98	19
				Mirdita	39,340	39	LE 2001-2039	LE 10020-10028	Rrëshen	14,259	14	25	5
									Rubik	8,108	8	14	4
				Kurbini	73,077	73	LE 3001-3073	LE 10029-10042	Laç	30,053	30	42	8
10	10 SHKODER	334	67						Mamurras	21,781	22	31	6
				Shkoder	248,263	248	SH 0001-0248	SH 10001-10049	Shkodër	112,710	113	224	44
				Malsi e madhe	51,933	52	SH 2001-2052	SH 10050-10059	Vau Dejës	12,325	12	24	5
				Puke	34,219	34	SH 3001-3034	SH 10060-10067	Koplik	11,239	11	52	10
									Pukë	5,809	6	19	4
11	11 TIRANE	952	190						Fushë Arrëz	4,648	5	15	4
				Tiranë	838,680	839	TR 0001-0839	TR 10001-10168	Tiranë	586,651	587	717	143
									Kamëz	80,506	81	100	20
				Kavajë	112,684	113	TR 2001-2113	TR 10169-10190	Vorë	17,977	18	22	5
									Kavajë	38,231	38	88	17
									Rrogozhinë	11,060	11	25	5

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
									Vlorë	126,900	127	190	38
				Vlorë	234,319	234	VL 0001-0234	VL 10001-10047	Himarë	11,391	11	17	3
									Orikum	10,846	11	17	3
	12 021 VLORE	359	72						Selenicë	7,123	7	10	3
				Sarandë	94,088	94	VL 2001-2094	VL 10048-10066	Sarandë	38,690	39	87	17
				Delvinë	30,770	31	VL 3001-3031	VL 10067-10072	Konispol	2,927	3	7	2
									Delevinë	13,867	14	31	6

Shënim: Ndarja e licencave sipas bashkive ne rang rrethi (kolona 13) do te behet sipas shembullit te mëposhtëm:

Rrethi: Berat ka 154 licenca, me numër serie BR 0001-0154 e cila do te ndahet: Për bashkine Berat me 130 licenca, me numër serie BR 0001-0130

Për Bashkine Ura Vaçurore me 24 licenca, me numër serial BR 0131-0154

Në të njëjtën mënyrë do ndahet edhe kuota rezervë e licencave për çdo Bashki ne rang rrethi sipas numrit te përcaktuar ne kolonën 14.

UDHËZIM
Nr.13, datë 19.7.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.370, DATË 28.1.2004 “PËR MODELET E
LICENCAVE, CERTIFIKATAVE DHE AUTORIZIMEVE PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, dhe ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit,

UDHËZON:

1. Në pikën 2 të udhëzimit nr.370, datë 28.1.2004, modeli 105, ndryshohet në formën dhe përmbajtjen si më poshtë vijon:

105	Licencë për transport udhëtarësh me taksì.	Ngjyrë portokalli e lehtë, letër sintetike, format A4, 150 gr/m ² ose më shumë	Inicialet e qarkut, kodi shifror i qarkut dhe numri serisë	Simboli i taksisë
-----	--	---	--	-------------------

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

Ngjyrë portokalli e lehtë, format A4, letër sintetike, 150 gr/m² ose më shumë
(Stema e Republikës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

EMËRTIMI I QARKUT _____

Bashkia _____

Incialet e qarkut
dhe kodi _____

Numri i serisë _____

LICENCË

Nr. _____, datë ____/____/____

PËR

TRANSPORT UDHËTARËSH ME TAKSI

I LËSHOHET:

Simboli Taksisë

Personit Fizik/Juridik: _____

Administratori: _____

Me seli në:

Tipi autoveturës: _____

Targa e taksisë: _____

Numri i taksisë: _____

Numri i vendeve: _____

Kjo licencë jep të drejtën e përfshirjes në transportin taksi të udhëtarëve e bagazheve të tyre, në përputhje me dispozitat e parashikuara në ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”.

Licenca është e vlefshme nga ____/____/____ deri më ____/____/____

Lëshuar në _____, më _____

Firma dhe vula
e autoritetit kompetent

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Licenca është personale e zotëruesit dhe nuk është e transferueshme.
2. Licenca mbahet gjithnjë në kopje origjinale dhe është e pavlefshme kur:
 - a) nuk shoqërohet me dëshminë e taksistit, aktin vlerësimin e kushteve në shërbimin taksi;
 - b) i ka përfunduar afati i vlefshmërisë;
 - c) në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme: emri i shoqërisë dhe adresa e selisë; nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse; data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.
3. Licenca hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, kur:
 - nuk plotësohen më kërkesat në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, reputacionin e mirë, kompetencën profesionale, gjendjen e përshtatshme financiare;
 - subjekti transportues kryen shkelje të rënda e të përsëritura në lidhje me sigurinë rrugore, gjendjen teknike të automjetit dhe me taksimetër jo në gjendje pune ose me taksimetër jashtë funksionimit, ose vula e të cilit është e prishur, e ndryshuar, e palexueshme;
 - provohet se subjekti transportues ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës dhe, ose gjatë ushtrimit të aktivitetit; ose
 - shkelen kushtet e vendosura në këtë licencë.
4. Niveli dysHEME i tarifave të shërbimit taksi, për të gjitha llojet e taksive, nuk mund të jetë më pak se dyfishi i çmimeve të shërbimeve të njëjta me autobus (për shërbimet në linja të rregullta, qytetëse, rrethqytetëse dhe ndërqytetëse).
5. Ndalohet shërbimi taksi i udhëtarëve në linjë të rregullt.
6. Në vendqëndrimet e taksive të caktuara nga bashkitë merren udhëtarë vetëm nga taksitë që janë nën juridiksionin e tyre.
7. Autoveturat taksi nuk kanë të drejtë të qëndrojnë, përveç vendqëndrimeve të caktuara nga bashkia, ku ato janë licencuar. Autoveturat taksi të bashkive të tjera vetëm mund të lënë udhëtarë në bashkinë, ku kanë pasur për qëllim destinacionin e shërbimit.
8. Pika e nisjes së autoveturës taksi është brenda juridiksionit të bashkisë, ku autovetura taksi është licencuar.
9. Drejtuesit e autoveturave taksi duhet të zbatojnë rregullat e shërbimit taksi, në përputhje me rregulloret e hartuara nga këshilli bashkiak.
10. Licenca duhet t’u paraqitet organeve të kontrollit në rrugë, sa herë që kërkohet prej tyre.
11. Kur autovetura taksi kryen shërbime jashtë territorit të rrethit, ku është e regjistruar, ajo lejohet të marrë në kthim:
 - a) udhëtarë vetëm në rrethin e regjistrimit të saj;
 - b) të njëjtët udhëtarë, të cilët e kanë prenotuar ose rezervuar më parë, në vajtje, dhe që kanë hipur në rrethin e regjistrimit të saj.
- Shërbimi taksi jashtë territorit të rrethit, sipas shkronjës “b)”, kryhet vetëm nëpërmjet agjencive të transportit të udhëtarëve të licencuara. Në këtë rast, autovetura taksi duhet të pajiset me dokumentin e udhëtimit për prenotimin/rezervimin, e plotësuar nga agjencia, dhe udhëtarët të jenë të pajisur me dokumentin e identifikimit, të cilat mbahen gjatë gjithë udhëtimit dhe u paraqiten organeve të kontrollit në rrugë, sa herë që kërkohet prej tyre, për të vërtetuar se shërbimi taksi është duke u kryer me grup të prenotuar ose rezervuar më parë.
- Organet e kontrollit në rrugë, pas verifikimit, janë të detyruar të vendosin në dokumentin e udhëtimit, emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e personit/personave që kanë kryer kontrollin.
12. Nga drejtuesi i autoveturës taksi nuk lejohet përdorimi i dokumentit të udhëtimit të udhëtarëve, përveç atij të miratuar nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe në përputhje me udhëzimin 1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.
13. Autovetura taksi është e ndaluar të përdoret për qëllime personale të subjektit.
14. Në rastin kur një person drejton një autoveturë taksi të papajisur me licencë, ose me licencë të vjedhur, ose të falsifikuar, ose me dokumente udhëtimit të falsifikuar, organet e kontrollit në

rrugë marrin licencën dhe mbajtësi i saj dënohet në përputhje me pikën 2 të nenit 85 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

15. Cilido që shkel kushtet e vendosura në licencë dënohet në bazë të nenit 8 dhe shkronjave “a” dhe “b” të nenit 68 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar dhe të pikës 3 të nenit 85 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, të ndryshuar “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

UDHËZIM
Nr.14, datë 19.7.2007

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1649, DATË 16.8.1999 “MBI
PLOTËSIMIN E DISA KUSHTEVE TË VEÇANTA NË TRANSPORTIN RRUGOR TË
UDHËTARËVE”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 9 paragrafit të parë të nenit 36, nenit 37, nenit 38 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe nenit 85 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit,

UDHËZON:

1. Në kapitullin IB, pas pikës 8, të shtohet pika 8 a, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“8 a. Për kontrollin në plotësimin e kushteve në komoditetin e autobusëve në transportin e udhëtarëve, Komisioni i Qendrës së Kontrollit Teknik pranë DPSHTRR-së, pas verifikimit në plotësimin e kushteve të kap. IB “Komoditeti i udhëtimit” lëshon për çdo autobus dokumentin në përputhje me aneksin 2 të këtij udhëzimi.

Aktivlerësimi në plotësimin e kushteve në komoditetin e autobusëve në transportin e udhëtarëve brenda vendit lëshohet çdo vit, pasi autobusi ka kaluar kontrollin teknik dhe është pajisur me modelin 020 të kontrollit teknik sipas udhëzimit nr.3413, datë 16.7.2003 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”.

Aktivlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve brenda vendit është pjesë përbërëse e procedurës së licencimit. Ky dokument mund të pezullohet ose hiqet gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe, ose refuzohet lëshimi i tij derisa këto kushte të plotësohen. Dokumenti mbahet në origjinal në autobus dhe u paraqitet organeve të kontrollit në rrugë sa herë kërkohet prej tyre.

Aktivlerësimi të komoditetit në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve brenda vendit u nënshtrohen edhe autoveturat me 8+1 vende, të cilat janë të licencuara në shërbimin e transportit të udhëtarëve në linja të rregullta rrethqytetëse, në përputhje me nenin 17 të ligjit 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar.

2. Në kapitullin III pika 4 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“4. Transporti i udhëtarëve i kryer në linjë të rregullt me anë të shërbimit taksi është i ndaluar. Autoveturat taksi nuk lejohet të qëndrojnë në stacionet e autobusëve të linjave të rregullta rrethqytetëse ose ndërëqytetëse, por mund të marrin ose të sjellin udhëtarë, me qëllim shërbimin brenda qytetit. Ndalohet qëndrimi i autoveturave taksi dhe marrja e udhëtarëve në stacionet e autobusëve të linjave qytetëse.

Në rastin kur autovetura taksi kryen udhëtime jashtë rrethit, ku ajo është e regjistruar, pika e nisjes se autoveturës taksi është brenda juridiksionit të bashkisë, ku ajo është licencuar.

Kur autovetura taksi kryen shërbime jashtë rrethit, ku është e regjistruar, ajo lejohet të marrë në kthim:

a) udhëtarë vetëm në rrethin e regjistrimit të saj;

b) të njëjtët udhëtarë, të cilët e kanë prenotuar ose rezervuar më parë, në vajtje, dhe që kanë hipur në rrethin e regjistrimit të saj.

Autovetura taksi mund të prenotohet nga udhëtari, nëpërmjet agjencisë, ose drejtpërsëdrejti nga ai në vendqëndrimin e taksive, ose në ecje e sipër etj.

Shërbimi taksi jashtë territorit të rrethit, sipas shkronjës “b”, kryhet vetëm nëpërmjet agjencive të licencuara për “Agjenci transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit”, në përputhje me udhëzimin

e licencimit.

Në këtë rast, autovetura taksi duhet të pajiset edhe me dokumentin e udhëtimit, në përputhje me aneksin 3a të këtij udhëzimi.

Agjencia pajis me dokumentin e udhëtimit vetëm autoveturat e licencuara në shërbimin taksi.

Gjithashtu, organet e kontrollit në rrugë, në rastin e shërbimit me grup të prenotuar/rezervuar më parë janë të detyruara të kontrollojnë edhe dokumentet e identifikimit të udhëtarëve që përbëjnë grupin.

Autovetura taksi është e ndaluar të përdoret për qëllime personale të subjektit.

Autovetura e licencuar taksi, e cila kryen udhëtime boshe jashtë rrethit të regjistrimit të saj, me qëllim zëvendësimin e autoveturave të licencuara taksi, që prishen ose dëmtohen gjatë udhëtimit të tyre, lejohet të marrë udhëtarët e autoveturës së licencuar taksi të dëmtuar ose të prishur. Në këtë rast, dokumenti i udhëtimit plotësohet me shënimet përkatëse nga agjencia nisëse dhe miratohet gjatë udhëtimit të kthimit nga organet e kontrollit në rrugë.

Në rastin kur një person kryen shërbimin taksi të papajisur me licencë, ose me licencë të vjedhur, ose të falsifikuar, ose me dokumente udhëtimi të falsifikuara, organet e kontrollit në rrugë marrin licencën dhe mbajtësi i saj dënohet në përputhje me pikën 2 të nenit 85 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

Cilido subjekt i licencuar nga autoriteti kompetent në veprimtarinë e shërbimit taksi dhe që operon në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dënohet në përputhje me nenin 8 ose 68 të këtij ligji dhe pikën 3 të nenit 85 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

Licenca, aktvlerësimi i kushteve në shërbimin taksi, dëshmia e taksistit dhe dokumentit të udhëtimit, në origjinal, do të mbahen gjithmonë me vete nga drejtuesi i autoveturës taksi dhe u paraqitet organeve të kontrollit në rrugë, sa herë kërkohet nga ata.”.

3. Në kapitullin III pika 7, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Dëshmia e drejtuesit të autoveturës taksi është pjesë përbërëse e dokumenteve për efekt licencimi në transportin e udhëtarëve me taksi. Për marrjen e dëshmisë drejtuesi i autoveturës taksi i nënshtrohet një provimi në përputhje me programin e hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

Dëshmia e drejtuesit të autoveturës së licencuar taksi mund të pezullohet ose hiqet gjatë ushtrimit të aktivitetit të profesionit dhe, ose refuzohet në rastin e rinovimit të saj nga autoriteti kompetent, që e ka lëshuar atë, kur:

a) hiqet licenca në shërbimin taksi;

b) drejtuesi i autoveturës shkel dispozitat e ligjit nr.8308, datë 18.3.1999 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, këtij udhëzimi e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të mësipërme;

c) vërtetohet se drejtuesi i autoveturës taksi kryen shkelje ndaj detyrimeve në trajtimin e udhëtarëve.

Afati i vlefshmërisë së dëshmisë së drejtuesit të autoveturës taksi mund të jetë deri në tre vjet, ose për një periudhë më të vogël se i vlefshmërisë së licencës në shërbimin taksi. Në këtë rast, autoriteti kompetent para testimit për lëshimin për herë të parë ose rinovimin e dëshmisë i kërkon drejtuesit të autoveturës taksi certifikatën mjekësore të lëshuar nga komisioni mjeko–ligjor.”

4. Pas kapitullit III shtohet kapitulli III/a me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Dokumenti i udhëtimit dhe numri i udhëtimeve në muaj në operacionet taksi me kthim plotë, blloku i udhëtimit dhe regjistri i dokumentit të udhëtimit

1. Autovetura e licencuar taksi, që kryen shërbimin jashtë rrethit të regjistrimit të saj, operon sipas shkronjës “b” të pikës 4 të kapitullit III, pajiset me dokumentin e udhëtimit nëpërmjet agjencive të licencuara për transport udhëtarësh.

- Dokumenti i udhëtimit duhet të plotësohet në të gjitha kërkesat që përfshin, si: numrin e licencës së agjencisë; emrin ose emrin tregtar të subjektit agjenci transporti; emrin ose emrin tregtar të subjektit transportues; kodin dhe numrin e serisë së licencës së subjektit transportues; emërtimin e bashkisë; emrat e personave që udhëtojnë në grup; numrat e dokumenteve të identifikimit; emri i agentit dhe nënshkrimi i tij; numri i telefonit të agjencisë dhe vula e agjencisë.

- Dokumenti i udhëtimit i lëshohet nga agjencia subjektit në shërbimin taksi, mbi bazën e një marrëveshjeje kontraktuale ndërmjet tyre, ajo nuk ka të drejtë t’i lëshojë dokument udhëtimi

subjekteve në shërbimin taksi të pakontraktuar. Subjekti në shërbimin taksi nuk ka të drejtë të kërkojë dokument udhëtimi nga agjenci, me të cilat nuk ka lidhur marrëveshje kontraktuale.

- Rastet e evidentuara në kundërshtim me paragrafin më sipër përbëjnë arsye deri në heqjen e licencës, për subjektin agjencia dhe atë në shërbimin taksi.

- Agjencia është përgjegjëse për saktësinë dhe korrektësinë e plotësimit të listës së udhëtarëve. Drejtuesi i autoveturës taksi nuk mund të pranojë dokumentin e udhëtimit me korrigjime.

- Drejtuesi i autoveturës taksi, pas kryerjes së shërbimit të prenotuar/rezervuar, kthen dokumentin e udhëtimit në agjencinë ku e ka tërhequr atë, menjëherë me përfundimin e shërbimit, duke ruajtur për vete një fotokopje të saj. Në rast se drejtuesi i autoveturës taksi nuk kthen dokumentin e udhëtimit, agjencia, që ka lëshuar këtë dokument, njofton zyrtarisht organet e kontrollit, të cilat marrin masa në plotësimin e këtij kushti.

- Blloku i udhëtimeve me kopjet e listës së udhëtarëve qëndron në agjenci dhe në çdo moment është subjekt kontrolli nga autoriteti kompetent që licencën agjencinë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, që lëshon bllokun e udhëtimit, si dhe organet e autorizuar me ligj.

- Agjencitë e transportit të udhëtarëve janë të detyruara t'i dërgojnë informacion Drejtorisë Rajonale të DPSHTR dhe bashkisë përkatëse, me listën për subjektet taksi, të cilat kanë kryer operacione të kthimit plotë, sipas shkronjës "b" të pikës 4 të kapitullit III të këtij udhëzimi, në dhjetëditëshin e parë të çdo muaji, për muajin paraardhës.

- Organet e kontrollit në rrugë, në mënyrë të veçantë, duhet të ushtrojnë kontrolle, nëse procedurat e operimit të autoveturës taksi janë të rregullta, ndaj të gjitha autoveturave taksi, të cilat në kthim, mbajnë në bordin e tyre udhëtarë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si autoritet kompetent, pajis me bllokun e udhëtimit, që përmban 25 fletë në dy kopje, agjencitë e transportit të udhëtarëve.

- Çdo bllok dhe dokument i udhëtimit do të kenë të njëjtin numër. Fletët e bllokut, krahas numrit të serisë së bllokut, do të shoqërohen edhe me numrat nga 1 deri 25.

- Të dhënat që kërkohen për t'u vendosur në kapakun dhe dokumentin e udhëtimit do të bëhen me shkrim të kuptueshëm dhe me shkronja kapitale.

- Faqja e parë e kapakut të bllokut të udhëtimit (shiko aneksin 4) duhet të plotësohet nga autoriteti kompetent që e lëshon, sipas të gjitha kërkesave që përfshihen mbi atë.

- Blloku i udhëtimit lëshohet në emër të një agjencie dhe nuk mund të transferohet te një subjekt tjetër agjencie.

- Autoriteti kompetent (DPSHTRR) që lëshon bllokun e udhëtimit do të regjistrojë të gjitha elementet si vijon:

- a) Emërtimin e subjektit;

- b) Adresën e vendndodhjes së agjencisë;

- c) Kodin dhe numrin e serisë së licencës për veprimtarinë në shërbimin agjenci;

- d) Emrin e njësisë vendore që ka lëshuar licencën në shërbimin taksi;

- e) Numrin e telefonit dhe, ose faksit të agjencisë.

- Blloku i udhëtimeve mund të pezullohet ose i hiqet subjektit gjatë ushtrimit të veprimtarisë në shërbimin agjenci dhe, ose refuzohet rilëshimi i një blloku të ri udhëtimesh nga autoriteti kompetent, në rastin kur:

- a) hiqet licenca në shërbimin agjenci;

- b) vërtetohet se subjekti agjenci nuk përmbush, direkt ose indirekt, detyrimet për zbatimin e legjislacionit në transportin rrugor dhe, në mënyrë të veçantë atë për mënyrën e operimit të autoveturës taksi;

- c) provohet se subjekti agjenci ka furnizuar me informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara nga organet e kontrollit ose autoritet kompetente të licencimit.

- Blloku i ri i udhëtimit i lëshohet çdo subjekti agjenci që licencuar, vetëm pasi ai kthen bllokun e udhëtimit të përfunduar në organin përkatës që e ka lëshuar atë me 25 fletët kopje të dokumenteve të udhëtimit/listave së udhëtarëve.

3. Drejtoria Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) pajis agjencitë me regjistër të veçantë vetëm për shërbimin taksi, sipas shkronjës "b" pikës 4 të kapitullit III të këtij udhëzimi.

- Regjistri përmban 50 fletë dhe shërben vetëm për regjistrimin e të gjitha autoveturave të licencuara në shërbimin taksi që kryejnë operacione sipas shkronjës "b" të pikës 4 të kapitullit III, me

grup të prenotuar/rezervuar më parë.

- Regjistri plotësohet në të gjitha kërkesat që përfshin, si: numrin e bllokut dhe dokumentit të udhëtimit; emrin ose emrin tregtar të autoveturës së licencuar taksi dhe të drejtuesit të saj; kodin dhe numrin e serisë së licencës së subjektit taksi, itinerarin e udhëtimit; datën e nisjes dhe të kthimit, etj.”.

5. Në kapitullin IV, pas pikës 8 shtohen pikat 9, 10 dhe 11, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“9. Komisioni i Qendrës së Kontrollit Teknik pranë DPSHTRR, pas verifikimit në plotësimin e kushteve të kapitullit IV “Kushte të veçanta të automjetit “TAKSI””, lëshojnë për autoveturën taksi dokumentin në përputhje me aneksin 3 të këtij udhëzimi. Aktivlerësimi i kushteve në shërbimin taksi për autoveturën taksi lëshohet çdo vit, pasi autovetura ka kaluar kontrollin teknik dhe është pajisur me modelin 020 të kontrollit teknik, sipas udhëzimit nr.3413, datë 16.7.2003 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”.

Aktivlerësimi i kushteve në shërbimin taksi është pjesë përbërëse e procedurës së licencimit. Ky dokument mund të pezullohet ose hiqet gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe, ose refuzohet lëshimi i tij derisa këto kushte të plotësohen.

10. Në aneksin 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi, jepen modeli i kapakut të bllokut të dokumentit të udhëtimit, faqja e përparme dhe e pasme e kapakut me dispozitat e përgjithshme, dhe aneksi 4a, që përfaqëson modelin e dokumentit të udhëtimit për shërbimin taksi me grup të prenotuar/rezervuar më parë.

11. Në aneksin 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi, jepen modeli i kapakut të regjistrimit të dokumentit, të dokumentit të udhëtimit dhe aneksi 5a, që përfaqëson modelin e faqes së brendshme të regjistrimit në të cilën regjistrohet dokumenti i udhëtimit për shërbimin taksi, me grup të prenotuar/rezervuar më parë.

Dokumentet e përmendura në pikat 10 dhe 11 të këtij kapitulli, në bazë të pikës 1.8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.473, datë 29.7.1998 “Për rregullat kryesore të veprimtarisë së agjencive të transportit të udhëtarëve dhe të transportuesve, që kryejnë transport me autobus”, ruhen nga agjencitë e transportit të udhëtarëve për pesë vjet.”.

6. Pas kapitullit IV shtohet kapitulli IV/a, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“1. Licencat për autoveturat në shërbimin taksi shtypen dhe emetohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Shpërndarja do të kryhet në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për përcaktimin e numrit të autoveturave taksi, shtypjen dhe emetimin e licencave, bllokut të udhëtimit dhe regjistrimit të shërbimit taksi” dhe aneksit 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Licencat në shërbimin taksi të pajisen me letër sintetike, ngjyrë portokalli e lehtë, format A4, 150 gr/m² ose më shumë, që përmban elemente sigurie, në mënyrë të tillë që të përjashtohet mundësia e kopjimit ose falsifikimit.

2. Pajisja me licencë rezervë e një subjekti që ushtron veprimtarinë në shërbimin taksi dhe lëshimi i saj nga autoriteti kompetent bëhet në rastin:

a) kur një licencë dëmtohet rëndë. Në këtë rast, subjekti e kthen licencën e dëmtuar në bashki, si autoritet kompetent, që ia ka lëshuar atë, e cila e dorëzon atë në zyrën e transportit të qarkut që e përfshin në juridiksion. Licenca e dëmtuar konsiderohet e pavlefshme në rastet kur në të janë bërë të palexueshme specifikimet e mëposhtme:

- i) emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;
- ii) nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;
- iii) data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë;
- iv) kodi i qarkut dhe numri i serisë dhe etj;

b) kur një licencë deklarohet e humbur ose e vjedhur. Në këtë rast, subjekti pezullon veprimtarinë dhe brenda pesë ditëve bën denoncimin te autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, i cili merr masat e duhura për njoftimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Policisë së Qarkullimit, Policisë Tatimore për licencën e humbur ose vjedhur shoqëruar me të gjitha specimetet që përmbahen në licencë;

c) kur një autoveturë taksi ka pësuar dëmtime të rënda të riparueshme, ose për arsye të ndryshme del nga qarkullimi dhe për këtë, subjekti pajiset me një autoveturë tjetër, ai e dorëzon licencën te autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, që ia ka lëshuar, i cili ia kthen zyrës së transportit në qark;

ç) kur një licencë humbet vlerën sipas dispozitave të nenit 7 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998

“Për transportet rrugore”, i ndryshuar ose hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë në përputhje me nenin 8 të ligjit të mësipërm.

Për shkronjat “c” dhe “d”, subjekti është i detyruar të dorëzojë licencën te autoriteti kompetent që e ka lëshuar, i cili vepron si në shkronjën “a” më sipër.

Për të gjitha rastet e mësipërme, zyra e transportit në qark njofton DPSHTR-në dhe organet e tjera të kontrollit në rrugë për pavlefshmërinë e licencës së përdorur, e cila ka dalë jashtë përdorimit, me numrin përkatës të serisë dhe njëkohësisht njoftojnë për numrin e serisë së licencës së re, rezervë, që e zëvendëson atë. Në njoftim, vendoset emërtimi i bashkisë që e lëshon licencën e re, rezervë.

Kohëzgjatja e të gjitha procedurave për pajisjen e subjektit me një licencë të re, rezervë nuk duhet të kalojë 30 ditë nga marrja e njoftimit, për dëmtimin, humbjen ose vjedhjen e licencës së autoveturës taksi.

Për zëvendësimin e një licence, për rastet e parashikuara në pikën 2 më sipër, ndalohet përdorimi i licencave nga kuota bazë.

7. Pas kapitullit IVa shtohet kapitulli IV b, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Krijimi i regjistrit kombëtar të subjekteve në shërbimin taksi

1. Me qëllim zbatimin e këtij udhëzimi krijohet regjistri kombëtar për subjektet e licencuara në shërbimin taksi.

2. Regjistri kombëtar vendoset pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të dhënat që përmban regjistri kombëtar trajtohen dhe mbikëqyren vetëm nga personat përgjegjës të caktuar për këtë qëllim në përputhje me ligjin nr.8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Informacioni i grumbulluar, për shkeljet në mënyrën e operimit të autoveturave taksi, ose shkelje të tjera serioze, nga organet e kontrollit në rrugë, autoritetet kompetente të licencimit etj., dërgohet te Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila i hedh në regjistër.

Regjistri kombëtar do të përmbajë të dhënat si më poshtë vijon:

a) emrin dhe formën juridike të subjektit në shërbimin taksi;

b) adresën e vendndodhjes së subjektit taksi;

c) emrin e drejtuesit të autoveturës taksi;

ç) numrin e serisë së licencës;

d) numrin, kategorinë dhe llojin e shkeljeve serioze dhe shkelje të vogla të përsëritura.

2. Gjithashtu, në regjistër do të hidhen të dhënat në lidhje me një subjekt në shërbimin taksi, licenca e të cilit është pezulluar ose anuluar. Në këtë rast këto të dhëna duhet të shoqërohen në regjistër me arsyet e pezullimit ose anulimit të licencës.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

ANEKSI 2

(letër me ngjyrë të bardhë, format: DIN A4)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

AKTVLERËSIMI
NË PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË KOMODITETIT, TË AUTOBUSËVE, NË
TRANSPORTIN E UDHËTARËVE BRENDA VENDIT

Lëshuar në zbatim të udhëzimit nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, kapitulli IB, Komisioni i ngritur për kontrollin në plotësimin e kushteve të komoditetit, të autobusëve, në transportin e udhëtarëve, kontrolloi autobusin:

Targa:.....
Marka:.....
Tipi:.....
Nr.shasisë:.....
Viti i prodhimit:.....
Nr. vendeve:.....
Numri i lejes së qarkullimit:.....
Emri i subjektit transportues:.....
Adresa e plotë e subjektit:.....
Me seli në qytetin:.....

dhe pasi verifikoi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përmbushjen e kërkesave të veçanta që kërkon udhëzimi,

Komisioni vlerësoi:

se autobusi i mësipërm plotëson kushtet e komoditetit në transportin e udhëtarëve, sipas kap.IB të udhëzimit nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

KOMISIONI

(Emri, mbiemri, firma)

(Emri, mbiemri, firma)

(Emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

KRYETARI

(emri, mbiemri, firma)

Lëshuar, më _____, i vlefshëm deri _____

Shënim: Ky dokument mbahet në mjet, në origjinal.

ANEKSI 3

(letër me ngjyrë të bardhë, format: DIN A4)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

AKTVLERËSIMI
NË PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË KOMODITETIT, TË AUTOVETURËS, NË
SHËRBIMIN TAKSI

Lëshuar në zbatim të udhëzimit nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar, kapitulli IV, Komisioni i ngritur për kontrollin e plotësimit të kushteve të veçanta në shërbimin taksi, kontrolloi autoveturën:

Targa:.....
Marka:.....
Tipi:.....
Nr.shasisë:..... Viti
prodhimit:.....
Nr. vendeve:.....
Numri i lejes së qarkullimit:.....
Emri i subjektit transportues:.....
Adresa e plotë e subjektit:.....
Me seli në qytetin:.....

dhe pasi verifikoi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përmbushjen e kërkesave të veçanta që kërkon udhëzimi,

Komisioni vlerësoi:

se autovetura e mësipërme plotëson kërkesat për shërbimin taksi të udhëtarëve, sipas kapitullit IV të udhëzimit nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

KOMISIONI

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

(emri, mbiemri, firma)

KRYETARI

(emri, mbiemri, firma)

Lëshuar, më _____, i vlefshëm deri _____
Shënim: Ky dokument mbahet në mjet, në origjinal.

ANEKSI 4

Model i bllokut të dokumentit të udhëtimit/listës së udhëtarëve në shërbimin taksi

(letër me ngjyrë jeshile: A5 = 14.72 cm x 21 cm)

(Kapaku, faqja e parë)

Numri serisë (libri nr.)

Shërbimi taksi me grup të prenotuar/rezervuar

LIBRI I DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT

Për transportin rrugor të udhëtarëve në shërbimi taksi jashtë rrethit të regjistrimit të autoveturës taksi në përputhje me shkronjën "b" të nenin 37 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar.

Emri ose emri tregtar i agjencisë së transportit:.....
.....

.....
Adresa:.....
.....

.....
.....

.....
(Agjencia që merr bllokun)

.....
(Firma dhe vula e autoritetit që lëshon bllokun)

ANEKSI 4

Ana e pasme e faqes së parë (kapakut) të modelit të bllokut të dokumentit të udhëtimit/listës së udhëtarëve
(letër me ngjyrë jeshile; format: A5 = 148.5cm x 105cm)

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Blloku i lëshohet vetëm agjencive të transportit të udhëtarëve të licencuara nga autoriteti kompetent, në përputhje me kapitullin III/1 të këtij udhëzimi.
2. Blloku nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj te një subjekt tjetër.
3. Blloku i ri tërhiqet pranë autoritetit kompetent që e lëshon atë, vetëm pasi dorëzohet blloku i përdorur.
4. Blloku i udhëtimeve mund t'i pezullohet ose hiqet subjektit gjatë ushtrimit të veprimtarisë në shërbimin agjenci dhe, ose refuzohet rilëshimi i një blloku të ri udhëtimesh nga autoriteti kompetent, në rastin kur:
 - hiqet licenca në shërbimin agjenci;
 - vërtetohet se subjekti agjenci nuk përmbush, direkt ose indirekt, detyrimet për zbatimin e legjislacionit në transportin rrugor dhe në mënyrë të veçantë atë për mënyrën e operimit të autoveturës taksi;
 - provohet se subjekti agjenci ka paraqitur informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara nga organet e kontrollit; ose
 - kur veprohet në kundërshtim me këto dispozita.
5. Dokumenti i udhëtimit (dokumenti i prenotimit/rezervimit) është i vlefshëm vetëm në rastin kur autovetura taksi kryen shërbime jashtë territorit të rrethit, ku është regjistruar dhe është prenotuar/rezervuar më parë nga një grup udhëtarësh, që hipin në bashkinë ku autovetura taksi është licencuar. Në këtë rast, ajo lejohet të transportojë në kthim vetëm grupin e udhëtarëve që e kishin prenotuar/rezervuar më parë atë.
6. Dokumenti i udhëtimit duhet të plotësohet në të gjitha kërkesat që përfshin, si: numrin e licencës së agjencisë; emrin, ose emrin tregtar të subjektit agjenci transporti; numrin e telefonit të agjencisë; emrin, ose emrin tregtar të subjektit transportues; kodin dhe numrin e serisë së licencës së subjektit transportues; emërtimin e bashkisë; emrat e personave që udhëtojnë në grup; numrat e dokumenteve të identifikimit; emri i agjentit dhe nënshkrimi i tij; numri i telefonit të agjencisë dhe vula e agjencisë.
7. Dokumenti i udhëtimit i paraqitet organeve të kontrollit në rrugë sa herë që kërkohet prej tyre. Organet e kontrollit në rrugë pas verifikimit janë të detyruar të vendosin emrin, mbiemrin dhe ta nënshkruajnë atë.
8. Blloku i udhëtimeve me kopjet e listës së udhëtarëve qëndron në agjenci dhe në çdo moment është objekt kontrolli nga institucionet që licencojnë agjencitë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor që ka lëshuar bllokun e udhëtimit, si dhe organet e institucioneve që ia lejon ligji.
9. Autovetura taksi, e cila kryen udhëtime bosh jashtë bashkisë ose rrethit të regjistrimit të saj, me qëllim zëvendësimin e autoveturave taksi që prishen ose dëmtohen gjatë udhëtimit të tyre, lejohet të marrë udhëtarët e autoveturës taksi të dëmtuar ose të prishur. Në këtë rast, dokumenti i udhëtimit plotësohet me shënimet përkatëse nga agjencia nisëse, dhe miratohet gjatë udhëtimit të kthimit nga organet e kontrollit në rrugë.”.
10. Drejtuesi i autoveturës taksi, pas kryerjes së shërbimit të prenotuar/rezervuar, kthen dokumentin e udhëtimit në agjencinë ku e ka tërhequr atë, menjëherë me përfundimin e shërbimit, duke ruajtur për vete një fotokopje të saj. Në rast se drejtuesi i autoveturës taksi nuk kthen dokumentin e udhëtimit/listën e udhëtarëve, organet e kontrollit në rrugë marrin masa për pezullimin e aktivitetit të tij deri në plotësimin e këtij kushti.

ANEKSI 4a

Dokument i udhëtimit
(letër me ngjyrë të bardhë: format A5 = 14.9 cm x 10.5 cm)

Numri i serisë së bllokut shoqëruar me numrin e serisë së fletës.....

Nr.licencës së agjencisë dhe afati vlefshmërisë.....

Numri telefonit të agjencisë nisëse.....

Emri ose emri tregtar i subjektit agjenci transporti:.....

Emërtimi i bashkisë që ka lëshuar licencën taksi:.....

Vendndodhja e agjencisë:.....

Emri i drejtuesit të autoveturës, kur është operator transporti taksi:.....

Emri taksistit pronar transportues:.....

Numri i serisë së licencës së subjektit transportues taksi:.....

Dokumenti i udhëtimit me grup të prenotuar/rezervuar

Itinerari i udhëtimit me të gjitha ndryshimet në se ka gjatë udhëtimit:.....			
Bashkia nga ku nisët taksia dhe data e nisjes	Vendi i destinacionit dhe data e mbërritjes	Km me ngarkesë	Km pa ngarkesë
Emri dhe mbiemri i udhëtuesit		Numri i dokumenti të identifikimit/certifikatë me fotografi të personit/personave të udhëtimit	
1.			
2.			
3.			
4.			
5.			
6.			
7.			
8.			

Emri i nëpunësit të agjencisë nisëse)

Emri, mbiemri i nëpunësit të kontrollit
Në nisje

Emri, mbiemri i nëpunësit të kontrollit
Në kthim

Shënim. Ky dokument mbahet në origjinal gjatë udhëtimit dhe është i vlefshëm vetëm në rastin për shërbim të prenotuar/rezervuar, dhe vlen për një udhëtim.

Të gjithë udhëtarët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi.

Drejtuesi i autoveturës ia paraqet këtë dokument organeve të kontrollit në rrugë, në nisje dhe në kthim, të cilët janë të detyruar të plotësojnë me emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin.

ANEKSI 5
Kapaku (faqja e parë)

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

REGJISTRI I LISTËS SË UDHËTARËVE PËR SHËRBIMIN TAKSI ME GRUP TË
PRENOTUAR/REZERVUAR
(letër me ngjyrë jeshile: A3 = 42 cm x 29.4 cm)

ANEKSI 5a
Faqja e dytë

REGJISTRI I LISTËS SË UDHËTARËVE PËR SHËRBIMIN TAKSI ME GRUP TË
PRENOTUAR/REZERVUAR
(letër me ngjyrë të bardhë: DIN A4)

(Kapaku, faqja e parë)

Numri serisë (libri nr.)

Numri i serisë së bllokut dhe dokum. të udhëtimit	Targa e autoveurës taksi	Emri dhe mbiemri i drejtuesit të autoveurës taksi	Kodi dhe numri i serisë së licencës së autoveurës taksi	Emri ose emri tregtar i subjektit transportues
1	2	3	4	7

UDHËZIM
Nr.15, datë 24.7.2007

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCAVE, AUTORIZIMEVE
DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN
RRUGOR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për qeverisjen vendore”, ligjit nr.8653, datë 31.7.2000 “Për ndarjen administrative të Republikës së Shqipërisë”;

duke adoptuar: rregulloret, direktivat dhe vendimet e Bashkimit Europian, rezolutat e Forumit Ndërkombëtar të Transportit (ECMT/CEMT) dhe të Kombeve të Bashkuara të zbatueshme në transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave;

me qëllim: rregullimin, disiplinimin dhe monitorimin e veprimtarisë së ushtruar ose që kërkohet të ushtrohet nga personat fizikë a juridikë në fushën e transportit rrugor, si dhe integrimin e plotë të tyre në tregun europian të transportit rrugor, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit,

UDHËZON:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në të drejtat që kanë personat fizikë ose juridikë për t’u pajisur me licencë/autorizim/certifikatë në fushën e transportit rrugor, lëshimin e lejeve (autorizimeve) të transportit dhe operimit në territorin shqiptar për subjektet e huaja dhe detyrimin e administratës shtetërore për trajtimin konform dispozitave ligjore, të kërkesave të personave fizikë dhe juridikë.

Ky udhëzim zbatohet në transportin rrugor të brendshëm dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimin e këtij udhëzimi, jepen përkufizimet e termave që përdoren në transportin rrugor, të unifikuara me termat e përdorura në direktivat dhe rezolutat e ECMT/CEMT të Bashkimit Europian, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale në transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave.

1. Ministri: ministria përgjegjëse për veprimtarinë e transporteve.
2. Ministër: personi i ngarkuar me detyrën e ministrit përgjegjës për veprimtarinë e transporteve.
3. Autoriteti kompetent: autoriteti nga i cili varen organet e transportit, dhe që është kompetent, në territorin ku kanë selinë subjektet për lëshimin e licencave/autorizimeve/ certifikatave.
4. Organe transporti: organet dhe zyrat që merren me transportin rrugor në ministri e organet në varësi të saj, si dhe zyrat në qark, bashki dhe komunë.
5. Licencë: leje për një periudhë të caktuar kohe dhe për një numër të pakufizuar udhëtimesh, për të kryer veprimtari transporti udhëtarësh dhe veprimtari transporti mallrash për të tretë dhe me qira brenda dhe/ose jashtë vendit.
6. Leje transporti (autorizim, leje bilaterale transporti): leje transporti ndërkombëtar për të

kryer një numër të pakufizuar udhëtimesh në linjë të rregullt udhëtarësh për një periudhë të caktuar kohe, ose bilaterale për udhëtarë ose për mallra për të kryer një ose disa udhëtime vajtje-ardhje, që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale, ku Republika e Shqipërisë është palë.

7. Leje operimi (autorizim): dhënie e të drejtës operatorëve të huaj të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve në linjë të rregullt ose vajtje-ardhje të operojnë, për një periudhë të caktuar kohe dhe për numër të pakufizuar udhëtimesh, si dhe vetëm për një pjesë të udhëtimit të tyre, brenda territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë.

8. Autorizim ECMT/CEMT: leje transporti (autorizim) ndërkombëtar multilateral shumë udhëtimesh dhe për një periudhë të caktuar kohe, për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të mallrave ndërmjet dy a më shumë shteteve anëtare të Forumit të Transportit Ndërkombëtar.

9. Certifikatë: dokument që mbahet në mjet dhe që:

a) provon zotërimin e licencës për rastet e transporteve rrugore të brendshme dhe ndërkombëtare, që janë subjekt licencimi;

b) i jep një mjeti rrugor me motor, të drejtën e operimit në transportet rrugore të brendshme dhe ndërkombëtare, për rastet e transporteve të mallrave për llogari të vet.

10. Autobus: Automjet i destinuar për transport njerëzish me më shumë se nëntë ndenjëse, duke përfshirë dhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit.

11. Taksi: Autoveturë e pajisur me licencë për transport të rastësishëm ose të prenotuar të udhëtarëve dhe që ka jo më pak se katër ndenjëse, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe jo më pak se katër dyer, për autoveturat me më pak se nëntë ndenjëse, dhe jo më pak se tre dyer funksionale për autoveturat me nëntë ndenjëse, duke përfshirë ndenjësen e drejtuesit të mjetit.

12. Kamion: automjet i destinuar për transportin e mallrave dhe të njerëzve të caktuar me përpunimin ose transportin e këtyre mallrave.

13. Kompleks mjeteesh: kombinim i dy mjeteve rrugore për transport mallrash, prej të cilëve njëri është mjet motorik dhe tjetri rimorkio ose gjysmërimorkio. Për efekt të pajisjes me leje transporti bilaterale, kompleksi i automjeteve konsiderohet një i vetëm.

14. Automjet i huazuar: çdo mjet rrugor, i cili me pagesë dhe për një periudhë të caktuar kohe, mbahet nga një sipërmarrës, i cili e përdor për transport udhëtarësh ose mallrash, kundrejt shpërblimit ose për llogari të vet, duke pasur një kontratë huapërdorjeje ose qiraje me pronarin e automjetit.

15. Mallra të rrezikshme: ato mallra (substancë dhe artikuj), të klasifikuar dhe shënuar si të rrezikshme nga Marrëveshja Europiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), transporti i të cilave në rrugë është i ndaluar ose i lejuar vetëm në kushtet e caktuara nga kjo marrëveshje.

16. Transport i brendshëm udhëtarësh ose mallrash: transporti i udhëtarëve ose mallrave për të tretë dhe me qira ose për llogari të vet, me itinerar që shtrihet tërësisht brenda territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë.

17. Transport ndërkombëtar udhëtarësh ose mallrash: transporti i udhëtarëve ose mallrave për të tretë dhe me qira ose për llogari të vet, me itinerar që shtrihet pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë dhe kur ky territor shërben si origjinë dhe/ose destinacion i udhëtimit.

18. Transit: udhëtim përmes territorit të një shteti në të cilin nuk ngarkohen apo shkarkohen mallra, ose ku nuk hipin apo zbresin udhëtarë.

19. Ndërmarrje: çdo person, fizik a juridik, për qëllime fitimi apo jo, çdo shoqatë ose grup individësh, pa personalitet juridik, me qëllim fitimi ose jo, apo çdo organ zyrtar, që ka personalitetin e vet ligjor apo varet nga një organ, që e ka këtë personalitet.

20. Operator transporti: çdo person, fizik dhe juridik, që kryen transport rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave.

21. Operator taksi: çdo person fizik dhe juridik, që kryen shërbimin taksi në transportin rrugor të udhëtarëve.

22. Transport i rregullt udhëtarësh: shërbim në linjë të rregullt transporti me frekuencë dhe itinerare të pandryshuara, ku udhëtarët mund të merren dhe të lihen në vendqëndrime të përcaktuara më parë. Ky shërbim kryhet vetëm me autobus dhe mund të jetë qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar dhe shërbim i rregullt i specializuar.

23. Transporti qytetës: shërbimi i rregullt i transportit me autobus, që plotëson nevojat e popullsisë së një qyteti, brenda vijave kufizuese të tij ose, duke lidhur qendra të rëndësishme ekonomike dhe sociale me pjesët e tjera të qytetit.

24. Transporti rrethqytetës: shërbimi i rregullt i transportit me autobus, i cili plotëson nevojat e popullsisë ndërmjet:

- a) bashkive brenda të njëjtit rreth;
- b) qendrës së komunës në drejtim të qytetit të të njëjtit rreth dhe anasjelltas;
- c) qendrave të komunave të një rrethi (pa lejim kalimi në qytet);
- d) qendrave të banuara të një komune në drejtim të qendrës së komunës dhe/ose të një komune tjetër dhe anasjelltas;
- e) qendrave të banuara të një komune;
- f) bashkive qendër rrethi me qendrat arkeologjike, historike dhe turistike, brenda rrethit.

25. Transporti ndërqytetës: shërbimi i rregullt i transportit me autobus, që plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet:

- a) bashkive qendër të rretheve të ndryshme, brenda një qarku, dhe bashkisë jo qendër rrethi, me bashki qendër të një rrethi tjetër, brenda një qarku;
- b) bashkive qendër të rretheve për qarqe të ndryshme;
- c) bashkisë jo qendër rrethi me qendër rrethi të qarqeve të ndryshme;
- d) bashkive qendër të rretheve me stacionet hekurudhore skajore, për vazhdimin e udhëtimit, duke ndryshuar llojin e transportit, aeroportin, portin ose bankinën liqenore.

26. Shërbimet e transportit ndërkombëtar në linjë të rregullt: shërbime në linjë të rregullt ndërkombëtare transporti, në përputhje me marrëveshjet bilaterale të transportit rrugor ku Republika e Shqipërisë është palë.

27. Shërbimet e rregullta të specializuara të transportit: shërbimet e rregullta të transportit që sigurojnë shërbim për një kategori të caktuar udhëtarësh. Shërbimet e rregullta të specializuara përfshijnë veçanërisht:

- a) transportin shtëpi – punë, të punonjësve;
- b) transportin shtëpi – institucion shkollor, të nxënësve dhe studentëve;
- c) transportet qytetëse kufitare, kur lejohen me marrëveshje ndërkombëtare.

Klasifikimi i këtyre shërbimeve si shërbime të rregullta nuk cenohet nga fakti që ato mund të ndryshojnë, në përputhje me kërkesat e përdoruesve.

28. Shërbime transporti vajtje – ardhje (lavjerrës) të udhëtarëve: shërbime që organizohen për të transportuar grupe udhëtarësh të formuar më parë nga e njëjta zonë nisjeje dhe me të njëjtën zonë destinacioni, me udhëtime të përsëritura vajtje dhe kthim. Të tilla grupe, të përbëra nga udhëtarë që kanë kryer udhëtimin e vajtjes, rikthehen në zonën e nisjes me anën e një udhëtimi pasues. Zonë nisjeje dhe destinacioni quhen vendet, së bashku me lokalitetet rrethuese, në të cilat respektivisht fillon dhe mbaron udhëtimi.

Në shërbimin vajtje-ardhje (lavjerrës), nuk merren ose lihen udhëtarë gjatë udhëtimit.

Udhëtimi i parë në kthim dhe udhëtimi i fundit në vajtje, për një seri udhëtimesh lavjerrës, duhet të kryhen me autobus bosh.

29. Shërbime transporti të rastit: ato shërbime transporti që nuk i përgjigjen përkufizimit të shërbimeve të rregullta dhe atij të shërbimeve lavjerrës.

Në shërbimet e rastit, nuk lejohen të lihen ose të merren udhëtarë gjatë udhëtimit, me përjashtim të rasteve kur kjo autorizohet nga autoriteti kompetent për territorin ku kryhet transporti.

Këto shërbime transporti nuk e humbin karakterin e shërbimit të rastit për faktin se mund të kryhen me një frekuencë të caktuar.

30. Transportet e udhëtarëve për llogari të vet: transportet e kryera për qëllime jotregtare dhe jofitimprurëse nga një ndërmarrje, me kusht që:

- a) veprimtaria e transportit të jetë vetëm një veprimtari ndihmëse për ndërmarrjen;
- b) mjetet e përdorura të jenë pronë e ndërmarrjes ose të jenë të blera me këste prej saj, ose të jenë objekt i një kontrate qiramarrjeje afatgjatë dhe të drejtohen nga një punonjës apo anëtar i ndërmarrjes.

31. Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion ose kompleks mjeteve për persona fizikë ose juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit apo kompleksit të mjeteve me qira me drejtues mjete.

32. Transporti i mallrave për llogari të vet: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast, transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore të ndërmarrjes së transportit, mjete është pronë ose me kontratë

qiramarrje e asaj ndërmarrjeje dhe drejtohet nga një punonjës apo anëtar i saj.

33. Agjenci spedicionere: personi juridik ndërmjetës, i cili planifikon dhe organizon transportin e mallrave dhe/ose shërbimet e lidhura me të, në emër të dërguesit të mallit.

34. Agjenci transporti udhëtarësh: personat fizikë ose juridikë që iu shërbejnë udhëtarëve e bagazheve, në nisjen e udhëtimit me autobus dhe në kthim, me dhënie informacioni, pajisje me dokumentet e udhëtimit, organizim udhëtimi dhe shërbime të tjera që lidhen me transportin, me qëllim mbërritjen e tyre të sigurt dhe në kohë në destinacionin e caktuar.

35. Dokument kontrolli: certifikatë, leje transporti (autorizim, leje bilaterale), leje operimi (autorizim), fletë ose libër udhëtimi, policë-ngarkesë, faturë e shitjes/blerjes së mallit, lista e udhëtarëve, kontrata e udhëtimit dhe çdo dokument që i përket mjetit, ngarkesës dhe drejtuesit të mjetit, që mbahen në original ose kopje e noteruar në bordin e automjetit gjatë gjithë udhëtimit dhe që shërbejnë për kontrollin e veprimtarisë së subjektit që kryen transportin.

“Marrëveshja interbus”: Marrëveshja për transportin ndërkombëtar rrugor të rastit të udhëtarëve me autobus.

“ADR”: Marrëveshja Europiane mbi transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme.

KREU II PRANIMI NË TREG DHE KOMPETENCAT NË LICENCIM

Neni 3 **Pranimi në treg**

1. Janë subjekt licencimi/autorizimi/certifikimi personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e:

- a) Transportit në linjë të rregullt të udhëtarëve të brendshëm dhe ndërkombëtar; transportet e rregullta të specializuara sipas shkronjës “c” (pika 27 neni 2);
- b) Shërbimit të transportit ndërkombëtar të rastit të udhëtarëve;
- c) Shërbimit të transportit ndërkombëtar vajtje-ardhje (lavjerrës) të udhëtarëve;
- d) Transportit taksi të udhëtarëve;
- e) Shërbimit agjenci transporti udhëtarësh;
- f) Transportit të mallrave, të brendshëm dhe ndërkombëtar;
- g) Shërbimit agjenci spedicionere;
- h) Konsulencës tekniko–ekonomike në transportin rrugor.

2. Shërbimet e rregullta të specializuara të transportit të udhëtarëve sipas shkronjës “a” dhe “b” (pika 27, neni 2), janë subjekt kontrolli i kontratës së lidhur midis subjektit transportues dhe institucionit për të cilin kryhet shërbimi. Bashkëlidhur kontratës lista e udhëtarëve.

3. Shërbimet e brendshme të transportit të rastit të udhëtarëve (turistike), janë subjekt kontrolli i dokumentit të udhëtimit dhe kontratës së lidhur midis subjektit transportues i licencuar për transport udhëtarësh dhe agjencisë turistike të udhëtimit.

4. Shërbimet e transportit të udhëtarëve, brenda vendit, për llogari të vet, janë subjekt kontrolli i dokumentit të udhëtimit.

Në dokumentin e udhëtimit të përpiluar nga ndërmarrja duhet të jenë pika e hipjes dhe e zbritjes së udhëtarëve, si dhe lista e udhëtarëve të cilët janë punonjës të ndërmarrjes. Mjetet dhe drejtuesi i mjetit të jenë në përputhje me shkronjën “b” të pikës 30 të nenit 2.

5. Shërbimet ndërkombëtare të transportit të udhëtarëve për llogari të vet, kryhen nëpërmjet dokumentit të miratimit nga shteti përkatës, kur përcaktohet në marrëveshjet bilaterale. Për rastet e tjera të papërcaktuara në këto marrëveshje janë subjekt kontrolli i dokumentit të udhëtimit, i përpiluar sipas paragrafit të mësipërm.

6. Shërbimet e udhëtarëve me taksi kur operojnë jashtë rrethit të regjistrimit në rastin kur autovetura taksi është e prenotuar ose rezervuar, janë subjekt kontrolli edhe i dokumentit të udhëtimit.

Neni 4

Transportet e liberalizuara të mallrave

Sipas marrëveshjes CEMT/ECMT (ku bën pjesë dhe Republika e Shqipërisë), për të lehtësuar transportin ndërkombëtar ndërmjet vendeve anëtare të saj, janë përjashtuar nga kërkesat për leje transporti bilaterale ose multilaterale, disa kategori të caktuara transporti (sipas aneksit nr.1).

Neni 5

Llojet e mjeteve dhe mallrave që nuk kanë nevojë për licencim/certifikim

Nuk kanë nevojë për licencë për transport për të tretë dhe me qira disa lloje të caktuara të mjeteve, të përcaktuara në pikën 1 të udhëzimit MPPTT nr.1648, datë 16.8.1999 (sipas aneksit nr.2).

Nuk kanë nevojë për certifikatë për transport brenda vendit, disa lloje të caktuara të mallrave, të përcaktuara në pikën 2 të udhëzimit të mësipërm (Sipas aneksit nr.2).

Neni 6

Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës/autorizimit/certifikatës

Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës/autorizimit/certifikatës, në veprimtaritë e transportit rrugor, përcaktohet si vijon:

Transporti i brendshëm i udhëtarëve

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti në linjë të rregullt qytetëse	Licencë	Bashkia
Transporti në linjë të rregullt rrethqytetëse	Licencë	Bashkia/ Komuna
Transporti në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	Licencë	Bashkia
Transporti në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	Licencë	Ministria
Transporti i udhëtarëve me taks	Licencë	Bashkia
Agjenci transporti udhëtarësh e shërbimi taks	Licencë	Bashkia/ Komuna
Shërbimet e rastit	Libër udhëtimi	Qarku

Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transport ndërkombëtar udhëtarësh	Licencë	Ministria
Shërbimet në linjë të rregullt	Autorizim	Ministria
Shërbimet e rregullta të specializuara	Autorizim	Ministria
Shërbimet vajtje-ardhje (lavjerrës)	Autorizim	Ministria
Shërbimet e rastit	Libër udhëtimi/ autorizim	Ministria
Agjenci transporti udhëtarësh	Licencë	Ministria

Transporti i mallrave brenda vendit

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti për të tretë dhe me qira	Licencë	Bashkia/qarku, për komunat
Transporti për llogari të vet	Certifikatë	Bashkia/ komuna
Transporti i mallrave të rrezikshme	Certifikatë	DPSHTRR
Transporti me mjete jashtë norme	Licencë	Ministria

4. Transporti ndërkombëtar i mallrave

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti për të tretë dhe me qira	Licencë	Ministria

Transporti për llogari të vet	Certifikatë	DPSHTRR
Transporti i mallrave të rrezikshme	Certifikatë	DPSHTRR
Transporti ndërmjet dy e më shumë shteteve anëtare të ECMT/CEMT	Autorizim	ANALTIR

5. Aktivitete të tjera

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti
Agjenci spedicionere	Licencë	Ministria
Konsulencë tekniko-ekonomiko në veprimtarinë e transportit rrugor	Licencë	Ministria

Licencat për transport udhëtarësh dhe mallrash, brenda dhe jashtë vendit, lëshohen të shoqëruara me certifikatën e mjetit me të cilin kryhet transporti.

Mjetet e certifikuara për transport udhëtarësh dhe mallrash për një shoqëri të caktuar, nuk certifikohen për të njëjtën periudhë, për llogari të subjekteve të tjera të transportit. Në rast se, gjatë kësaj periudhe kërkohen ndryshime, subjekti për të cilin mjeti është certifikuar duhet të dorëzojë në zyrën e licencave certifikatën origjinale të mjetit.

Leja e transportit (autorizimi), leja e operimit (autorizimi), certifikata e mjetit, libri i udhëtimit, lista e udhëtareve/dokumenti i udhëtimit në original mbahen në bordin e mjetit dhe shërbejnë si dokument kontrolli. Mbajtësi i tyre është i detyruar t'ia paraqesë kur kërkohet, organeve të kontrollit.

Neni 7

Transporti ndërkombëtar i udhëtarëve me një shtet me të cilin Republika e Shqipërisë është palë në një marrëveshje bilaterale transporti rrugor, shoqërohet me lejen e transportit (autorizim) të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit/shtetet, në territorin e të cilit/cilëve transiton ose ku përfundon linja.

Transporti ndërkombëtar i mallrave rregullohet nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale ose multilaterale të transportit rrugor. Ky lloj transporti mund të jetë i lirë (pa leje/autorizim) ose i shoqëruar me leje (autorizim) me shtetin përkatës me të cilin do të kryhet transporti dhe/ose transitit.

Lejet e transportit (autorizimet), shpërndahen nga Ministria ose nga organet që iu është deleguar kjo e drejtë.

Transporti ndërkombëtar i rastit i udhëtarëve, realizohet kundrejt librit të udhëtimit/lejes së transportit (autorizimit) të lëshuar nga Ministria. Libri i udhëtimit dhe autorizimi për shërbimet e rastit të paliberalizuara lëshohen në bazë të marrëveshjes INTERBUS (për vendet palë në këtë marrëveshje). Për shtetet e tjera mund të jetë i lirë ose me autorizim në bazë të marrëveshjeve bilaterale.

KREU III

KRITERET BAZË TË LICENCIMIT

Neni 8

Kriteret e licencimit

Për të ushtruar veprimtarinë e transportit të udhëtarëve dhe mallrave, e cila është subjekt licencimi, ndërmarrjet e transportit rrugor paraqesin kërkesë për licencim pranë autoritetit kompetent.

Personi fizik apo juridik, që kërkon të licencohet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve e mallrave, duhet të provojë se plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) reputacionin e mirë;
- b) gjendjen e përshtatshme financiare;
- c) kompetencën profesionale;
- d) zotërimin e mjeteve të transportit rrugor me motor, në numrin dhe gjendjen teknike të kërkuar.

Kur kërkuuesi i licencës (aplikanti) është një person që nuk përmbush kërkesat e shkronjës “c”, autoriteti kompetent mund ta licencojë atë me kushtin që ai të emërojë një person tjetër që plotëson

kërkesat e shkronjave “a” dhe “c” më sipër, i cili do të menaxhojë efektivisht dhe në mënyrë të vazhdueshme operacionet e transportit të ndërmarrjes.

Kur aplikanti nuk është një person fizik, kërkesat e shkronjës “a” dhe “c” duhet të përmbushen nga personi ose personat që drejtojnë efektivisht aktivitetin e transportit të ndërmarrjes.

1. Kërkesa për reputacion të mirë plotësohet në rast se personi fizik ose personat që menaxhojnë efektivisht aktivitetin e ndërmarrjes:

- nuk janë shpallur fajtorë për krime ose shkelje serioze ligjore, përfshirë edhe krime ose shkelje të natyrës tregtare;

- nuk janë deklaruar të papërshtatshëm për të ushtruar veprimtarinë e operatorit të transportit sipas legjislacionit në fuqi;

- nuk janë shpallur fajtorë për shkelje serioze të ligjit të punës, legjislacionit të transportit, për shkelje të rregullave lidhur me kohën e drejtimit dhe pushimit për drejtuesin e mjetit, ose për legjislacionin lidhur me trafikun rrugor, sigurinë e mjetit dhe në mbrojtjen e mjedisit.

Kërkesa për reputacion të mirë do të quhet e plotësuar edhe për personin ose personat që janë deklaruar të rehabilituar.

2. Kërkesa për gjendje të përshtatshme financiare plotësohet kur disponohen burime të mjaftueshme financiare, të cilat garantojnë ecurinë dhe administrimin e ndërmarrjes së transportit.

Kur subjekti aplikon për licencë, autoriteti kompetent pranon në formën e një vërtetimi, konfirmimi nga Banka ose institucioni tjetër të kualifikuar vlerësimin e gjendjes financiare (bilancin vjetor të sipërmarrjes; fondet që ajo disponon, përfshirë depozitat bankare; kreditë dhe huat lehtësuese; asetet duke përfshirë pronat të cilat ndërmarrja mund t'i lërë peng si garanci; kostot duke përfshirë koston e blerjes ose pagesën fillestare të mjetit; makineri - pajisjet dhe kapitalin punues).

Vlerësimi i gjendjes financiare duhet të jete i barabartë ose që kapërcen shumën e përgjithshme të:

- a) 4000 euro për mjetin e parë dhe 2000 euro për çdo mjet shtesë, kur kryen transport ndërkombëtar mallrash me leje multilaterale ECMT/CEMT;

- b) 2000 euro për mjetin e parë dhe 1000 euro për çdo mjet shtesë, kur kryen transport ndërkombëtar udhëtarësh dhe mallrash;

- c) 30 000 lekë, për mjetin e parë dhe 15 000 lekë për çdo mjet shtesë, kur kryen transport të mallrave dhe të udhëtarëve brenda vendit, si dhe në shërbimin taksit;

- d) 10 000 euro, kur aplikon për agjenci spedicionere;

- e) 700 000 lekë, kur aplikon për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh.

3. Kërkesa për kompetencë profesionale plotësohet kur provohet zotërimi i njohurive të mjaftueshme juridike, tregtare, financiare dhe teknike për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor.

- Në transportin e brendshëm rrugor të udhëtarëve, në veprimtarinë e shërbimit taksit, në veprimtarinë e agjencisë së transportit të udhëtarëve (brenda vendit dhe ndërkombëtare), kërkesa për kompetencë profesionale plotësohet me zotërimin e diplomës në inxhinieri mekanike ose ekonomik. Kur personi nuk zotëron diplomën e përmendura në këtë paragraf, ai duhet të jetë i pajisur me Certifikatën e Kompetencës Profesionale për transport brenda vendit.

- Në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave, si dhe të agjencisë spedicionere kjo kërkesë plotësohet, me zotërimin e diplomës në inxhinieri mekanike ose ekonomik. Kur personi nuk zotëron diplomën e përmendura në këtë paragraf, ai detyrimisht duhet të jetë i pajisur me Certifikatën e Kompetencës Profesionale për transport ndërkombëtar.

- Në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme kërkesa për kompetencë profesionale plotësohet, përveç zotërimit të Certifikatës së Kompetencës Profesionale, sipas veprimtarive përkatëse ose zotërimit të diplomës universitare në inxhinieri mekanike ose ekonomik, edhe me zotërimin e Certifikatës së Trajnimit, si Këshilltar i Sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme.

Plotësimi i kërkesave të kompetencës profesionale në transportin ndërkombëtar të mallrave ose udhëtarëve, plotëson automatikisht edhe kërkesat e kompetencës profesionale në veprimtarinë përkatëse të transportit të brendshëm.

Dallimi ndërmjet Certifikatës së Kompetencës Profesionale të lëshuar për transportin e brendshëm dhe asaj për transportin ndërkombëtar përcaktohet nga niveli i programeve të trajnimit, në përgatitjen profesionale të drejtuesve të veprimtarisë së subjekteve.

Certifikata e Kompetencës Profesionale lëshohet nga DPSHTRR, shoqata, institucione të

njohura nga ministria, si dhe institucione të huaja, të njohura nga autoriteti kompetent i shtetit ku janë vendosur këto institucione.

4. Kërkesa për gjendjen teknike të mjeteve rrugore provohet, nëpërmjet plotësimit të standardeve të sigurisë rrugore të mjetit, standardeve të nxjerrjes së gazrave dhe zhurmave, si dhe kërkesat e komoditetit në transportin e udhëtarëve.

Qendra e Kontrollit Teknik për mjetet që kryejnë transportin e udhëtarëve krahas certifikatës mod 020 dhe mod 021, sipas udhëzimit nr.3413, datë 16.7.2003 “Mbi kontrollin teknik të mjeteve rrugore”, lëshon edhe dokumentin e aktvlerësimit në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve, në përputhje me aneksin 2 dhe 3 të udhëzimit nr.1649, datë 16.8.1999 “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, të ndryshuar.

a) Në transportin rrugor të udhëtarëve (qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, shërbimin taksi, ndërkombëtar me autobus) subjekti dorëzon për licencim aktvlerësimin në plotësimin e kushteve të komoditetit për transport në përputhje me udhëzimin nr.1649, datë 16.8.1999, të ndryshuar.

b) Në transportin rrugor të mallrave subjekti dorëzon për licencim certifikatën e kontrollit teknik model 020 për transport të brendshëm dhe për mjetet rrugore që kryejnë transport ndërkombëtar certifikatën e kontrollit teknik model 021.

c) Në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave standardet teknike të automjeteve duhet të jenë në përputhje edhe me marrëveshjet bilaterale, marrëveshjen INTERBUS dhe rezolutat ndërkombëtare (ECMT/CEMT) që rregullojnë veprimtarinë përkatëse.

5. Numri i autobusëve në transportin e udhëtarëve në linja të rregullta përcaktohet nga zyra e licencave në bazë të frekuencës së udhëtimeve, distancës së udhëtimit dhe mjeteve rezervë që duhet të ketë ndërmarrja e transportit.

Neni 9

Lëshimi, refuzimi dhe heqja e licencës, autorizimit, certifikatës

1. Lëshimi i licencës, autorizimit, certifikatës

- Licenca lëshohet kur aplikanti plotëson kërkesat sipas këtij udhëzimi.
- Licenca, leja e transportit (autorizimi) dhe certifikata nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj te një subjekt tjetër.

- Titullari i licencës, për kryerjen e veprimtarisë për të cilën është licencuar ose autorizuar, mund të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me një subjekt të tretë, por jo për më shumë se 35 % të veprimtarisë. Titullari i licencës ose autorizimit është përgjegjës për plotësimin e kushteve të licencimit/autorizimit edhe për pjesën e veprimtarisë që kryhet nga nënkontraktori.

- Në rast se personi fizik ose juridik, ndryshon emrin, e vërtetuar kjo me vendim gjykatë ose çdo element tjetër, me kërkesë të tij kryhet zëvendësimi përkatës i licencës, autorizimit, certifikatës me të njëjtin afat vlefshmërie dhe me një numër tjetër identifikimi, duke arkivuar përkatësisht licencën, autorizimin, certifikatën e vjetër.

- Në rast se subjekti i transportit, brenda 60 ditëve nga dita e lëshimit, nuk tërheq licencën, autorizimin ose certifikatën, atëherë këtij i anulohet licenca, autorizimi ose certifikata. Në rastin e linjave ndërqytetëse të transportit të udhëtarëve, autoriteti kompetent në ministri njofton edhe bashkinë që ka lëshuar autorizimin për subjektin.

- Licenca, autorizimi ose certifikata anulohet edhe me kërkesë të subjektit transportues. Në transportin e udhëtarëve në shërbimet e rregullta, autoriteti kompetent që ka lëshuar licencën, autorizimin ose certifikatën njoftohet të paktën dy muaj përpara ndërprerjes së veprimtarisë. Në kërkesën për anulim licence/autorizimi/certifikate duhet të përcaktohet data e ndërprerjes së shërbimit dhe arsyet e kësaj ndërprerjeje.

2. Refuzimi i kërkesës për licencim/autorizim/certifikim

Kërkesa për licencim/autorizim/certifikim refuzohet kur subjekti që kërkon të licencohet/autorizohet/certifikohet:

- nuk plotëson kërkesat sipas këtij udhëzimi;
- nuk plotëson kërkesat specifike të linjës së rregullt në transportin e udhëtarëve;
- ka paraqitur informacion jokorrekt në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës/autorizimit/certifikatës;
- nuk plotëson kërkesat për rinovim të licencës/autorizimit/certifikatës, të përcaktuara me këtë

udhëzim;

- provohet se deklarinimet nga personi/personat për marrjen e licencës/autorizimit/certifikatës janë të pavërteta.

3. Heqja e licencës/autorizimit/certifikatës.

Licenca/autorizimi/certifikata hiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, kur:

- Subjekti transportues i licencuar nuk i plotëson më kushtet e nenit 8, (reputacioni i mirë, kompetenca profesionale, gjendje e përshtatshme financiare dhe zotërimi i mjeteve të transportit rrugor me motor, në numrin dhe gjendjen teknike të kërkuar);

- Subjekti transportues e transferon licencën/autorizimin/certifikatën e tij te një tjetër;

- Subjekti i autorizuar për shërbim transporti udhëtarësh në linjë të rregullt kryen shkelje të rënda e të përsëritura në lidhje me kushtet e përshkruara në licencë/autorizim për itinerarin, vendqëndrimet, frekuencën dhe oraret;

- Subjekti transportues, në shërbimet në linjë të rregullt, brenda vendit dhe ndërkombëtare, të udhëtarëve, nuk fillon veprimtarinë brenda 60 ditëve nga data e marrjes së licencës ose ndërpret veprimtarinë për më shumë se 45 ditë;

- Provohet se subjekti transportues ka paraqitur deklarinime të pavërteta, informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës/autorizimit/ certifikatës;

- Licencat e ECMTCEMT-it hiqen edhe në rastin e përdorimit të pamjaftueshëm të tyre ose të kufizuar vetëm në transportet dypalëshe (bilaterale) ose shkeljeve të tjera të udhëzimit të përdorimit të lejeve CEMT.

Neni 10

Pavlefshmëria dhe zëvendësimi i licencës, autorizimit dhe certifikatës

Licenca, autorizimi dhe certifikata është e pavlefshme kur:

- I ka përfunduar afati i vlefshmërisë;

- Në të janë bërë të palexueshme ose mungojnë specifikimet e mëposhtme:

a) Emri i shoqërisë dhe adresa e selisë;

b) Nënshkrimi i autoritetit kompetent dhe vula përkatëse;

c) Data e fillimit dhe mbarimit të periudhës së vlefshmërisë.

- Zëvendësimi i licencës, autorizimit dhe/ose certifikatës bëhet me kërkesë të titullarit të saj për rastet kur deklarohet e humbur, e vjedhur, e shkatërruar ose kur ka humbur vlefshmërinë si më sipër.

Autoriteti kompetent që ka lëshuar licencën, autorizimin dhe/ose certifikatën lëshon dublikatë me të njëjtin përmbajtje dhe afat vlefshmërie.

- Autorizim i përkohshëm 1-mujor për vazhdimin e veprimtarisë jepet nga autoriteti kompetent që i ka lëshuar ato, për rastet e rinovimit të licencës, autorizimit ose certifikatës, kur vonesat në rinovim, që nuk janë përgjegjësi e aplikantit, rrezikojnë ndërprerjen e veprimtarisë. Autorizimi lëshohet vetëm kur automjetet kanë certifikatë të vlefshme të kryerjes së kontrollit teknik të tyre.

Neni 11

Afati i vlefshmërisë së licencës, autorizimit dhe certifikatës

Afatet e vlefshmërisë së licencave/autorizimeve/certifikatave nga data e lëshimit të tyre janë:

1. Licenca/rinovimi i licencës, për shërbimin taksi, lëshohet me afat 5-vjeçar.

2. Licenca/rinovimi i licencës për të gjithë veprimtaritë e transportit rrugor, me përjashtim të pikës 1, lëshohet me afat trevjeçar.

3. Autorizimi për operim në një linjë të rregullt ndërkombëtare transporti me autobus lëshohet me afat trevjeçar. Autorizimi për shërbimet vajtje-ardhje lëshohet me afat deri në një vit.

4. Afati i lejes së operimit (autorizimit) në linjë të rregullt të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve, për subjektet e huaja, përcaktohet sipas marrëveshjeve bilaterale. Kur nuk përcaktohet në to, lëshohet në bazë të parimit të reciprocitetit.

5. Certifikatat e automjeteve janë me afat njëvjeçar. Afati i certifikatës së automjeteve që shoqërojnë licencën nuk e kalon afatin e vlefshmërisë së licencës.

6. Autorizimi/konfirmimi i autorizimit që i jepet subjektit nga bashkia e qytetit ku fillon linja për t'u licencuar në transport ndërqytetës udhëtarësh në linjë të rregullt, ka një periudhë vlefshmërie 60-ditore deri në datën e dorëzimit të dokumentacionit në zyrën përkatëse të licencave. Në autorizim/konfirmim autorizimi nuk përcaktohet periudha e vlefshmërisë së licencës, e cila është kompetencë e autoritetit që e lëshon atë.

KREU IV FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËR DHËNIEN E LICENCE/AUTORIZIMEVE/ CERTIFIKATAVE

Neni 12

Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave

1. Kërkesat dhe dokumentacioni i personave fizikë dhe juridikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari transporti rrugor, dorëzohen në zyrën e licencave të transportit të caktuar për këtë qëllim nga Ministri ose autoriteti kompetent.

Zyra e licencave pranon dokumentacionin nga subjektet aplikante, vetëm duke u bazuar në rregullshmërinë ligjore të tyre në zbatim të këtij udhëzimi. Çdo kërkesë shqyrtohet paraprakisht brenda ditës, nëse përmban të plotë e të saktë gjithë dokumentacionin përkatës sipas këtij udhëzimi.

Dokumentacioni pranohet vetëm i dorëzuar nga personi fizik dhe, për rastet e personit juridik, nga administratori ose i autorizuari prej tyre me akt noterial. Veprimet kryhen kundrejt paraqitjes së dokumentit të identifikimit ose një dokumenti të barasvlershëm me të.

Dokumentet e një subjekti quhen zyrtarisht të dorëzuara, duke filluar nga data kur subjekti i ka plotësuar ato, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi dhe i ka protokolluar në zyrën e licencave.

2. Dokumentet për rinovimin e licencave, autorizimeve, certifikatave, paraqiten mbi 30 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tyre. Kërkesa për rinovim të lejes së transportit (autorizimit) për territoret e shteteve të tjera dorëzohet 60 ditë përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

Dokumentet e paraqitura sipas kërkesave të këtij udhëzimi duhet të jenë origjinale ose kopje të noteruara.

3. Zyra e licencave përgatit materialin për dhënien e licencës, autorizimit, lejes së operimit (autorizimit)/certifikatës vetëm për ato subjekte, të cilat kanë plotësuar dokumentacionin, sipas kërkesave të këtij udhëzimi. Materiali duhet të jetë i plotë dhe të pasqyrojë me hollësi të gjitha elementet e nevojshme për dhënien e lejes për veprimtarinë përkatëse. Ky material shqyrtohet nga eprori/eprorët përkatës dhe miratohet prej tyre. Materiali i përgatitur, kthehet në vendim, pasi miratohet nga Ministri ose autoriteti kompetent. Vendimi bëhet në dy kopje. Zyra e licencave, mbi bazën e vendimit, përgatit formatet sipas standardeve të miratuara.

Nga rregulli i paragrafit të mësipërm përjashtohen certifikimi i automjeteve që shoqërojnë licencën, certifikimi i automjeteve shtesë apo ricertifikimi në transportin e udhëtarëve dhe të mallrave brenda afatit të licencës.

4. Lejet e transportit (autorizimet) dhe lejet e operimit (autorizimet) në transportin ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave, nënshkruhen nga Drejtori i Përgjithshëm që mbulon Drejtorinë e Licencave në Ministri.

Certifikatat e automjeteve, nënshkruhen nga Drejtori i Licencave në Ministri, dhe nga drejtori që mbulon veprimtarinë e transportit në DPSHTRR/qark/bashki/komunë.

Data e lëshimit të licencës, autorizimit, lejes së operimit (autorizimit) dhe/ose certifikatës është data e dorëzimit të tyre në zyrën e licencave, të nënshkruara nga Ministri, personat e autorizuar prej tij ose nga autoriteti kompetent.

5. Licencat, lejet dhe të gjitha dokumentet për transport që lëshohen, sipas emërimit të këtij udhëzimi, janë subjekt i pagesës në llogarinë e autoritetit kompetent që i lëshon ato, në bazë të tarifave të miratuara. Të ardhurat që grumbullohen, shënohen në një regjistër të veçantë me të gjitha ekstremet e tyre.

Formatet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për çdo veprimtari transporti, janë dokumente standarde dhe miratohen nga Ministri.

6. Zyra e licencave bën inspektimin dhe verifikimin e deklarimeve të administratorit/

pronarit/pronarëve të shoqërisë dhe drejtuesit të veprimtarisë brenda një afati 60-ditor nga dorëzimi i dokumentacionit. Procedurat dhe afatet e verifikimit nuk pengojnë procesin e licencimit të subjekteve. Në rastet e konstatimit të deklarimeve të rreme zbatohen masat e përcaktuara në pikën 3 të nenit 9.

Neni 13

Ruajtja dhe arkivimi i dokumenteve

Zyra e licencave mban shënime të plota në një regjistër vjetor të dorëzimit të praktikave të subjekteve dhe të dhënies së licencave/autorizimeve/certifikatave.

Zyra e licencave arkivon praktikat në bazë të veprimtarive përkatëse sipas rendit alfabetik të subjektit, duke mbajtur shënimet e plota, të arkivimit dhe dorëzimit të tyre. Dokumentacioni ruhet në këtë zyrë për një periudhë trevjeçare dhe më pas dorëzohet në arkivin qendror të autoritetit kompetent.

Zyra e licencave, mbi bazën e vendimit, përgatit licencat/autorizimet në dy kopje origjinale, njëra prej të cilave pas nënshkrimit i dorëzohet subjektit përkatës e vulosur, ndërsa tjetra ruhet për arkivim.

Zyra e licencave përgjigjet për arkivimin sipas rregullave në fuqi të licencës/autorizimit/certifikatës, dokumentacionit, kërkesës dhe mandatit të arkëtimit për pagesën sipas tarifës përkatëse.

Neni 14

Komunikimi me subjektet

1. Zyra e licencave të transportit ka të drejtën e komunikimit zyrtar me subjektin, për plotësimin e dokumentacionit deri në marrjen e licencës, autorizimit, certifikatës.

Licencat, i dorëzohen subjektit nga zyra e licencave të transportit së bashku me dokumentet shoqëruese.

Subjektet e licencuara dhe ato që aplikojnë për licencim duhet të respektojnë detyrimet që burojnë nga ky udhëzim.

2. Zyra e licencave duhet t'i japë përgjigje subjektit për miratim ose jo të kërkesës brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të dokumenteve.

- Në rast se subjektit i refuzohet kërkesa për marrjen e licencës/autorizimit/certifikatës, atëherë atij i lind e drejta e ankesës me shkrim kundër refuzimit brenda 1 muaji nga dita kur aplikanti ka marrë njoftimin me shkrim për mosmiratimin e kërkesës.

- Autoriteti kompetent shqyrton ankimin e subjektit dhe del me një vendim brenda 1 muaji nga data e depozitimit të ankimit.

- Në rastin e mosveprimit nga ana e administratës (mosdhënies së përgjigjes), 3 muaj nga dita e dorëzimit të dokumenteve, licenca/autorizimi quhet i miratuar. Zyra e licencave duhet të pajisë subjektin me dokumentin e kërkuar.

KREU V

KËRKESA TË PËRGJITHSHME

Neni 15

Aplikim për herë të parë

1. Formulari i autodeklarimit (sipas aneksit 3).

2. Dokumentin e kredibilitetit bankar, që vërteton gjendje të përshtatshme financiare, sipas pikës 2 të nenit 8 për veprimtarinë përkatëse.

3. Dokumenti që vërteton zotërimin e kompetencës profesionale, sipas pikës 3 të nenit 8, për veprimtarinë përkatëse.

Kur kjo kërkesë nuk plotësohet nga pronari ose administratori i shoqërisë, subjekti paraqet kontratën me kohëzgjatje të paktën njëvjeçare me drejtuesin e veprimtarisë që plotëson kërkesën e kompetencës profesionale.

4. Vendimi i regjistrimit në gjykatë vetëm për personin juridik (aktiviteti që kërkohet të jetë në objektin e veprimtarisë).

5. Dokumentin e gjendjes teknike të mjetit sipas shkronjave “a”, “b”, “c” të pikës 4 të nenit 8 dhe lejen e qarkullimit për çdo mjet.

- Për transportin për llogari të vet nuk kërkohen dokumentet sipas pikës 2 dhe 3.
- Për shërbimin agjenci nuk kërkohen dokumentet sipas pikës 5 të këtij neni.

Neni 16

Aplikim për përsëritjen e veprimtarisë

1. Formulari i autodeklarimit (sipas aneksit 3).
2. Evidenca statistikore vjetore, sipas formularit të miratuar nga Ministria.
3. Dokumentin e gjendjes teknike të mjetit sipas shkronjave “a”, “b”, “c” të pikës 4 të nenit 8 dhe lejen e qarkullimit për çdo mjet.
 - Për transportin për llogari të vet nuk kërkohet dokumenti sipas pikës 2.
 - Për shërbimin agjenci nuk kërkohet dokumenti sipas pikës 3 të këtij neni.

KREU VI

KËRKESA TË VEÇANTA SIPAS VEPRIMTARIVE

Përveç, kërkesave të përgjithshme, aplikantët për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e transportit rrugor, duhet të paraqesin edhe kërkesa të veçanta për çdo lloj veprimtarie si më poshtë:

TRANSPORT RRUGOR UDHËTARËSH BRENDA VENDIT

Neni 17

1. Autorizimi i bashkisë së qytetit ku fillon linja është e drejta që i jepet një subjekti juridik transporti për të operuar në një linjë ndërqytetëse të rregullt transporti udhëtarësh me autobus.

Autorizimi lëshohet vetëm për linjat e miratuara nga ministri/kryetari i këshillit të qarkut në rrjetin e linjave të transportit ndërqytetës të udhëtarëve.

Autorizimi lëshohet për operim në linja të reja, të palicencuara ose për linja ku nuk operohet më.

Bashkia e qytetit, nëpërmjet një komisioni vlerësues të emëruar nga kryetari i bashkisë, përzgjedh me konkurs të hapur subjektin juridik, i cili do të quhet kandidat për të operuar në një linjë të caktuar të rregullt udhëtarësh.

Përzgjedhja kryhet mbi bazën e plotësimit më të mirë të kriterëve bazë të licencimit.

Subjekti duhet të ketë licencë për agjenci udhëtarësh ose kontratë me një agjenci tjetër të licencuar të qytetit ku fillon linja. (Kontrata i bashkëngjitet formularit të autodeklarimit).

Subjekti paraqet:

a) Dokumentet sipas nenit 15 (pikat 1, 4 dhe 5).

Në bazë të vendimit të komisionit vlerësues, kryetari i bashkisë lëshon autorizimin për subjektin e transportit të përzgjedhur.

Në autorizim duhet të shënohet:

- Emri i subjektit, selia e tij.
- Emërtimi i linjës ndërqytetëse.
- Oraret e nisjes, duke respektuar numrin e orareve të miratuara.
- Targat e autobusëve që do operojnë në këtë linjë.

Autobusët duhet të jenë me targat e rrethit të bashkisë ku fillon linja.

2. Konfirmim për plotësim të kushteve të autorizimit përkatës lëshohet nga bashkia e qytetit ku fillon linja për efekt të rinovimit të licencës dhe me kërkesë të subjektit të transportit. Ky dokument duhet të ketë elementet e autorizimit (emrin e subjektit, selinë, emërtimin e linjës, oraret e nisjes, targat e autobusëve).

Subjekti paraqet:

a) Dokumentin sipas nenit 16 (pika 1).

Bashkia bën monitorimin e veprimtarisë së subjektit të autorizuar prej saj dhe të licencuar nga autoriteti kompetent. Për mosplotësim të kushteve të licencimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë, bashkia njofton subjektin duke i lënë afat për plotësimin e tyre. Nëse bashkia konstaton se subjekti nuk plotëson kushtet e licencimit të dokumentuara nga organet e kontrollit (DPSHTRR, organet e policisë

së qarkullimit rrugor, organet tatimore), njofton dhe i propozon autoritetit kompetent të lëshimit të licencës marrjen e masave, sipas nenit 9 të këtij udhëzimi.

Organi kompetent i lëshimit të licencës, pasi shqyrton kërkesën e bashkisë, njofton subjektin duke i lënë atij afat prej 30 ditësh për të bërë sqarimet përkatëse pranë bashkisë. Në rast se nuk ka informacion ose prova të reja, organi kompetent i lëshimit të licencës me vendim miraton propozimin e bashkisë.

3. Vërtetimi i miratimit të orareve të kthimit nga bashkia/komuna e stacionit fundor të linjës.

Bashkia/komuna e stacionit fundor të linjës miraton oraret e kthimit për subjektet e bashkive/komunave ku fillon linja. Bashkia/komuna lëshon përkatësisht vërtetim ose konfirmim për miratimin e orareve të kthimit në përshtatje me kërkesën për transport të udhëtarëve.

Bashkë me kërkesën për miratim të orareve të kthimit subjekti paraqet:

1. Autorizimin e lëshuar nga bashkia ku fillon linja, ose konfirmimin e autorizimit (në rastin e linjave ndërqytetëse).

2. Kontratën me agjencinë e udhëtarëve në stacionin fundor.

Bashkia/komuna e stacionit fundor të linjës është e detyruar të miratojë orare të përshtatshme të kthimit për subjektet e bashkive/komunave ku fillon linja, brenda një afati prej 15 ditësh nga paraqitja e dokumenteve nga subjekti.

Në rast të kundërt, autoriteti kompetent për lëshimin e licencës, përcakton me vendim oraret e kthimit, duke njoftuar bashkinë/komunën përkatëse për zbatimin e tyre.

Neni 18

Transporti qytetës

Licenca për këtë veprimtari lëshohet vetëm për subjekte juridike brenda rrjetit të linjave që këshilli i bashkisë i përcakton me vendim të veçantë. Për përzgjedhjen e subjektit transportues do të përdoren kriteret bazë të licencimit.

Neni 19

Transporti rrethqytetës

Licenca për këtë veprimtari lëshohet për subjekte fizike dhe juridike.

Rrjeti i linjave rrethqytetëse dhe oraret e tyre miratohen nga këshilli i qarkut, duke pasur parasysh kërkesën për transport të udhëtarëve.

Licenca për këto linja jepet nga kryetari i bashkisë/komunës, ku ka selinë subjekti transportues. Procedurat për përzgjedhjen e subjektit transportues janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikën 1 të nenit 17.

Transportuesi, në linjat e rregullta rrethqytetëse, me përjashtim të linjave që lidhin dy bashki të një rrethi, krahas autobusëve mund të përdorë edhe autovetura 8+1 vende.

Subjekti duhet të paraqesë kontratën me një agjenci për udhëtarë brenda vendit, në bashkinë/komunën ku fillon linja, si dhe vërtetimin e miratimit të orareve të kthimit nga bashkia/komuna e stacionit fundor të linjës.

Neni 20

Transporti ndërqytetës i udhëtarëve me autobus

Licenca për transportin ndërqytetës iu lëshohet vetëm personave juridikë.

Rrjeti i linjave ndërqytetëse ndërmjet qarqeve të ndryshme dhe oraret e tyre miratohen me urdhër të Ministrit, i cili jep edhe licencën për këto linja.

Rrjeti i linjave ndërqytetëse brenda një qarku dhe oraret e tyre miratohen nga këshilli i qarkut. Licenca për këto linja jepet nga kryetari i bashkisë, ku ka selinë subjekti transportues.

Subjekti paraqet:

a) Autorizimin nga bashkia e qytetit ku fillon linja.

b) Vërtetimin e miratimit të orareve të kthimit nga bashkia e stacionit fundor të linjës.

Për rinovimin e licencës subjekti transportues duhet të paraqesë:

a) Konfirmim të autorizimit të bashkisë së qytetit ku fillon linja.

b) Vërtetimin nga bashkia e stacionit fundor të linjës për miratimin e orareve të kthimit.
Për nenet 18, 19 dhe 20 më sipër:

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, subjekti transportues mund të ndërrojë e rifreskojë inventarin e autobusëve që operojnë në linjë, por gjithnjë brenda kriterit të numrit, gjendjes teknike të tyre dhe shenjës së targës të rrethit përkatës.

Neni 21

Transporti i udhëtarëve me taksi

Licenca për këtë veprimtari lëshohet për persona fizikë dhe juridikë. Transporti i udhëtarëve me taksi sigurohet nëpërmjet:

- shërbimit taksist - pronar, kur subjekti zotëron si pronë një autoveturë taksi.
- shërbimit ndërmarrje (kompani) – taksish, kur subjekti zotëron si pronë ose të huazuar më shumë se një autoveturë taksi. Në këtë rast subjekti është person juridik.

Subjekti paraqet:

a) Dokumentin për verifikimin dhe plumbosjen e taksimetrit lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit (DKMK).

Neni 22

Agjenci transporti udhëtarësh e taksi brenda vendit

Licenca për ushtrimin e kësaj veprimtarie iu lëshohet personave fizikë ose juridikë.

Subjekti i bashkëngjit formularit të autodeklarimit dokumentin e pronësisë ose qiramarrjes mbi zyrën/zyrat e agjencisë. Zyra/zyrat duhet të ndodhen në vend të përshtatshëm për t'i shërbyer udhëtarëve.

Neni 23

Transportet e rastit të udhëtarëve brenda vendit

Transporti i rastit i udhëtarëve, brenda vendit me autobus kryhet vetëm nga subjekte të licencuara për transport udhëtarësh në linja të rregullta rrethqytetëse, ndërqytetëse ose turistike. Për marrjen e librit të udhëtimit subjekti paraqet:

a) Kontratën me agjenci turistike.

Libri i udhëtimit përdoret për 10 udhëtime të shërbimeve të rastit.

Për rinovim të librit të udhëtimit subjekti dorëzon librin paraardhës me kopjet e fletëve të përdorura.

TRANSPORT NDËRKOMBËTAR UDHËTARËSH ME AUTOBUS

Neni 24

Transport ndërkombëtar udhëtarësh me autobus

Licenca për ushtrim veprimtarie në transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve me autobus lëshohet vetëm për persona juridikë të organizuar në shoqëri transporti.

Subjekti paraqet:

a) Dokumente që vërtetojnë se subjekti ka eksperiencë mbi tre vjet në transport udhëtarësh. Kjo eksperiencë e subjektit vërtetohet me eksperiencën e pronarit/pronarëve, administratorit ose e drejtuesit të veprimtarisë me të cilin ka një kontratë pune, me afat jo më pak se një vit.

b) Dokument që vërteton se subjekti zotëron si pronë ose të huazuar, me afat jo më pak se një vit, të paktën një autobus të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.

Për rinovimin e licencës kërkohet vetëm dokumenti i shkronjës “b” më sipër.

Kjo licencë, kur nuk është e shoqëruar nga një leje (autorizim) transporti ndërkombëtar për operim në linjë të rregullt ose për transport të rregullt të specializuar, ose transport lavjerrës, i jep subjektit të drejtën për të ushtruar veprimtari transporti ndërkombëtar udhëtarësh me autobus vetëm për shërbime të rastit.

Autorizim për shërbim transporti ndërkombëtar udhëtarësh në linjë të rregullt/të rregullt të specializuar/shërbimit vajtje-ardhje

Autorizimi për operimin në një linjë të rregullt të caktuar, në transportin e rregullt të specializuar ose në shërbimin lavjerrës iu lëshohet vetëm subjekteve të licencuara për transport ndërkombëtar udhëtarësh.

1. Autorizim për të operuar në një linjë të rregullt ndërkombëtare transporti me autobus

- Autorizimi lëshohet për linja të rregullta ndërkombëtare të miratuara nga autoritetet kompetente, palë në një marrëveshje bilaterale për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve. Miratimi i linjës nënkupton miratimin e itinerarit, vendqëndrimeve, frekuencës së udhëtimeve.

Subjekti duhet të jetë i pajisur me licencën e agjencisë për transport ndërkombëtar udhëtarësh, kur është i licencuar për këtë veprimtari agjencie, ose kontratën me një subjekt që është i licencuar për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh. (Kontrata i bashkëngjitet formularit të autodeklarimit).

Subjekti paraqet:

a) Dokumentin që vërteton se subjekti zotëron si pronë ose të huazuar nëpërmjet një kontrate, me afat jo më pak se një vit, numrin e nevojshëm të autobusëve të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.

b) Kontratën e partneritetit ose kontratë me një agjenci të licencuar në shtetin tjetër, ose licencën për shërbimin agjenci sipas legjislacionit në fuqi të shtetit tjetër, (kur kërkohet sipas marrëveshjeve bilaterale).

c) Hartën me itinerarin dhe vendqëndrimet e linjës.

d) Grafikun e linjës me ditët dhe oraret e nisjes dhe të mbërritjes.

e) Projekttarifat e biletave.

Për rinovim të autorizimit subjekti paraqet dokumentet, brenda periudhës së vlefshmërisë, sipas shkronjave “c”, “d”, “e”.

Për rastet e zgjatimit të linjave të rregullta të transportit të udhëtarëve me autobus, autorizimi i lëshuar ndaj subjektit që operon në linjë është i vlefshëm dhe ka të njëjtën periudhë vlefshmërie edhe për zgjatimin e linjës.

2. Autorizimi për shërbimet e rregullta të specializuara (sipas shkronjës c të pikës 27, neni 2)

Shërbimet e rregullta të specializuara rregullohen me të njëjtat procedura, si dhe ato të shërbimeve në linjë të rregullt.

Për pajisjen me autorizim, subjekti paraqet dokumentet sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Autorizim për shërbim ndërkombëtar transporti vajtje-ardhje (lavjerrës)

Në autorizimin për shërbime transporti vajtje-ardhje (lavjerrës) të udhëtareve përcaktohet zona e nisjes dhe zona e destinacionit.

Për pajisjen me autorizim subjekti paraqet:

a) Dokumentin që vërteton se subjekti zotëron si pronë ose të huazuar nëpërmjet një kontrate, me afat jo më pak se një vit, numrin e nevojshëm të autobusëve të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar të udhëtarëve.

b) Itinerarin e linjës, vendqëndrimet dhe frekuencën e udhëtimeve.

Për pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni:

Pas lëshimit të autorizimit, Drejtoria e Licencimit në ministri i kërkon autoritetit kompetent të shtetit tjetër, palë në marrëveshje të transportit rrugor, lëshimin e autorizimit për subjektin shqiptar për të operuar ose transituar në territorin e atij shteti.

Për tu pajisur me autorizim për territoret e vendeve ku kalon linja transit ose ku përfundon linja, subjekti transportues paraqet 60 ditë përpara përfundimit të afatit të autorizimit ekzistues, kërkesën së bashku me katër kopjet e dokumenteve sipas shkronjave “c”, “d” dhe “e” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 26

Leje operimi (autorizim) për subjektet e huaja të transportit për të operuar në një linjë të rregullt ndërkombëtare transporti me autobus

Për subjektet e shteteve të huaja, palë në marrëveshje bilaterale, me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti dhe të kontratës së shërbimit agjenci, Drejtoria e Licencimit në ministri lëshon autorizimin (lejen e operimit).

Autorizimi (leja e operimit) lëshohet edhe për subjektet e huaja që kërkojnë të kalojnë transit përmes Shqipërisë, në përputhje me marrëveshjet bilaterale dhe me kërkesë të autoritetit kompetent të atij shteti.

Neni 27

Libër udhëtimi/leje transporti (autorizim) për shërbim transporti ndërkombëtar të rastit me autobus

Transporti ndërkombëtar i rastit i udhëtarëve me autobus, realizohet në përputhje me Marrëveshjen Interbus. Autobusët për të kryer shërbime ndërkombëtare të rastit sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të jenë me standardet teknike të paraqitura në anekset e saj.

- Shërbimet e rastit të liberalizuara realizohen nëpërmjet librit të udhëtimit.

- Shërbimet e rastit të paliberalizuara realizohen me autorizim të lëshuar nga autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ndodhet pika e nisjes.

- Marrëveshja Interbus nuk ka lidhje me shërbimet e rastit për llogari të vet.

Me shtetet, të cilët nuk janë anëtare të Marrëveshjes Interbus, transportet e rastit kryhen në përputhje me marrëveshjet bilaterale. Ato mund të jenë të lira ose subjekt leje transporti (autorizim).

Libri i udhëtimit/autorizimi për shërbim të rastit lëshohet për subjektet e licencuara për transport ndërkombëtar udhëtarësh.

1. Për marrjen e librit të udhëtimit ose autorizimit për vendet, të cilat nuk janë anëtare të Marrëveshjes Interbus, subjekti paraqet:

a) certifikatën e lëshuar nga ministria për transport ndërkombëtar udhëtarësh ose certifikata e autobusit model 021.

Libri i udhëtimit përdoret për 25 udhëtime të shërbimeve të rastit.

Për marrjen e librit të udhëtimit subjekti dorëzon librin paraardhës me kopjet e fletëve të përdorura.

2. Për marrjen e autorizimit për shërbime të rastit të paliberalizuara subjekti transportues, i cili nuk është vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, paraqet:

a) Formularin e aplikimit sipas Marrëveshjes Interbus.

b) Licencën e lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit ku është vendosur subjekti.

3. Për kryerjen e shërbimit të transportit për llogari të vet, kur përcaktohet në marrëveshjet bilaterale, subjekti paraqet:

a) Kërkesën për kryerjen e këtij shërbimi.

b) Datat e hyrje daljes, itinerarin e udhëtimit, vendqëndrimet dhe pikat e kalimit kufitar.

c) Emrin/mbiemrin e drejtuesit të grupit dhe dokumentet e autobusit.

Në këtë rast, pas komunikimit të autoritetit kompetent me shtetin tjetër, subjekti pajiset me dokumentin e miratimit nga ky shtet.

Neni 28

Agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh

Licenca për ushtrimin e kësaj veprimtarie iu lëshohet vetëm personave juridikë.

Subjekti paraqet:

a) Dokumenti i pronësisë ose qiramarrjes mbi zyrën/zyrat e agjencisë, i bashkëngjitet formularit të autodeklarimit.

b) Kur subjekti nuk është i licencuar për transport ndërkombëtar udhëtarësh, të paktën një kontratë me një transportues ndërkombëtar udhëtarësh. (Kjo kontratë i bashkëngjitet formularit të autodeklarimit).

Subjekti i pajisur me licencë për agjenci transporti ndërkombëtar udhëtarësh mund të ushtrojë

edhe veprimtarinë e agjencisë për transport të brendshëm udhëtarësh, kur zyra/zyrat e tij janë në vend të përshtatshëm për shërbim agjencie ndaj këtij transporti.

Për rinovimin e licencës dokumenti sipas shkronjës “a” më sipër.

TRANSPORT RRUGOR MALLRASH BRENDA VENDIT

Kamionët me kapacitet transportues nën 500 kg nuk certifikohen për transport mallrash brenda vendit.

Neni 29

Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira brenda vendit

Licenca për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit lëshohet për subjekte fizike dhe juridike.

Kjo licencë vlen edhe për transportin e mallrave për llogari të vet brenda vendit.

Për mjetet që kryejnë transport mallrash të rrezikshme për të tretë dhe me qira brenda vendit subjekti duhet të paraqesë edhe dokumentet sipas shkronjave a dhe b të nenit 31.

Neni 30

Transporti i mallrave për llogari të vet brenda vendit

Veprimtaria e transportit të mallrave për llogari të vet brenda vendit, ushtrohet kundrejt certifikatës.

Kjo certifikatë lëshohet për subjekte fizike ose juridike.

Neni 31

Transporti i mallrave të rrezikshme brenda vendit

Veprimtaria e transportit të mallrave të rrezikshme brenda vendit për llogari të vet ushtrohet kundrejt certifikatës së mallrave të rrezikshme.

Kjo certifikatë lëshohet për çdo subjekt, fizik ose juridik, që kërkon të kryejë transport mallrash të rrezikshme brenda vendit. Subjekti paraqet:

a) Certifikatën e aprovuar për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme të caktuara (sipas ADR), e lëshuar nga DPSHTRR-ja.

b) Certifikatën e kontrollit të pajisjes së transportueshme për mallra të rrezikshme, lëshuar nga Instituti i Enëve Nënpresion.

Për rinovimin e certifikatës për transport mallrash të rrezikshme, kërkohen dokumentet sipas shkronjave “a” dhe “b”.

Neni 32

Transporti i mallrave me mjete jashtë norme

Licenca për transport mallrash me mjete jashtë norme lëshohet vetëm për subjekte juridike.

Kjo licencë, i jep të drejtën subjektit vetëm për të bërë regjistrimin e mjetit.

Subjekti paraqet:

a) Certifikatën e kontrollit fizik të mjetit.

Pas kësaj subjektit i lind e drejta të pajiset me licencën/certifikatën në ushtrimin e veprimtarisë përkatëse, në përputhje me kërkesat sipas këtij udhëzimi.

TRANSPORT NDËRKOMBËTAR RRUGOR MALLRASH

Neni 33

Transporti ndërkombëtar i mallrave për të tretë dhe me qira

Licenca për këtë veprimtari i lëshohet vetëm personave juridikë, të cilët disponojnë jo më pak se 60 ton kapacitet transportues dhe/ose tërheqës. Kamionët me kapacitet mbartës nën 3.5 ton nuk

certifikohen për transport mallrash për të trete dhe me qira.

Licencën për transportin ndërkombëtar të mallrave për të tretë dhe me qira mund ta fitojë edhe çdo subjekt juridik, i cili duke plotësuar kushtet e mësipërme, kryen veprimtarinë e transportit krahas veprimtarive të tjera për të cilat është licencuar, qoftë edhe për një pjesë të automjeteve që disponon.

Licenca për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira jep edhe të drejtën për transport mallrash brenda vendit për të tretë e me qira, si dhe për transportin e mallrave për llogari të vet brenda dhe jashtë vendit.

Kur subjekti kërkon licencë për transport me automjete të specializuara, hiqet kushti i kapacitetit transportues mbi 60 ton, si më sipër.

Transport i specializuar konsiderohet transporti i mishit, prodhimeve të freskëta të detit, transporti i makinerive dhe peshave të rënda në platforma, transporti i veturave në platforma të posaçme, transporti i mallrave të rrezikshme etj.

Në kuptimin e mjeteve të specializuara për zbatimin e këtij paragrafi, kategorizohen automjete termos dhe frigoriferike, tërheqës dhe platformat e transportit të veturave etj.

Për mjetet që kryejnë transport ndërkombëtar mallrash të rrezikshme duhet të paraqesë edhe dokumentet sipas nenit 31.

Neni 34

Transporti ndërkombëtar i mallrave për llogari të vet

Për transportin e mallrave për llogari të vet kapaciteti i çdo mjeti nuk mund të jetë më pak se 1 ton.

Veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet ushtrohet kundrejt certifikatës. Kjo certifikatë lëshohet për subjekte fizike ose juridike.

Neni 35

Transporti ndërkombëtar i mallrave të rrezikshme

Veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme për llogari të vet ushtrohet kundrejt certifikatës.

Kjo certifikatë lëshohet për çdo subjekt fizik ose juridik që kërkon të kryejë transport ndërkombëtar mallrash të rrezikshme.

Subjekti paraqet dokumentet sipas nenit 31.

RINOVIMI I CERTIFIKATËS SË AUTOMJETEVE PËR SUBJEKTET TË CILAT KANË LICENCË NË TRANSPORTIN E UDHËTARËVE DHE MALLRAVE

Neni 36

Subjektet juridike që janë të pajisur me licencë me afat mbi njëvjeçar janë të detyruara të paraqesin për certifikim automjetet për çdo vit.

Për rinovimin e certifikatave të automjeteve që shoqërojnë licencën me afat mbi njëvjeçar në transportin e udhëtarëve dhe mallrave, subjekti paraqet për çdo vit dokumentacionin sipas pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 16.

Neni 37

Transport multilateral në vendet anëtare të ECMT/CEMT

Lejet multilaterale (autorizimet) ECMT/ CEMT iu lëshohen vetëm subjekteve të licencuara për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira.

Subjekti paraqet:

a) Certifikatën standard të kontrollit të gazrave dhe zhurmave për mjete EURO1, EURO2, EURO3 dhe EURO4. Kjo certifikatë lëshohet nga prodhuesi i mjetit ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij në vendin e regjistrimit të mjetit.

b) Certifikatën standard të sigurisë rrugore për mjetin me motor dhe për rimorkion ose gjysmërimorkion, për mjete EURO2, EURO3 dhe EURO4. Kjo certifikatë lëshohet nga prodhuesi i

mjetit, nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij në vendin e regjistrimit të mjetit, ose nga DPSHTRR-ja.

Autorizimi CEMT lëshohet bashkë me karnetën e rrugës, e cila përdoret për të kontrolluar përdorimin e autorizimit ECMT/CEMT. Ajo mbahet në mjet bashkë me autorizimin.

Për të aplikuar sërish për autorizim ECMT/CEMT, subjekti transportues duhet të dorëzojë në zyrën e licencave, autorizimet e përdorura dhe karnetat e rrugës. Për lëshimin e autorizimit ECMT/CEMT, mbahet parasysh mënyra e përdorimit nga ana e subjektit të autorizimit paraardhës.

Subjektet transportuese të cilat nuk i kanë përdorur autorizimet e ECMT/CEMT-it, janë të detyruar t'i kthejnë ato pranë zyrës së licencave. Në rast të kundërt, humbasin të drejtën për t'u pajisur përsëri me autorizim, vitin pasardhës.

Autorizimi/Autorizimet ECMT/CEMT, të anuluar ose të kthyer të papërdorura nga një subjekt transportues, iu jepen, për periudhën e mbetur të vlefshmërisë, subjekteve të tjera transportuese që kanë bërë kërkesë.

Autorizimi ECMT/CEMT duhet të kthehet në zyrën e licencave brenda 15 ditëve pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

Neni 38

Agjenci spedicionere

Licenca për veprimtari të agjencisë spedicionere u lëshohet vetëm personave juridikë.

Subjekti i bashkëngjit formularit të autodeklarimit dokumentin e pronësisë ose qiramarrjes mbi zyrën/ zyrat e agjencisë.

Neni 39

Konsulenca tekniko-ekonomike në veprimtaritë e transportit rrugor

Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së konsulencës tekniko-ekonomike në transportin rrugor u lëshohet personave fizikë dhe juridikë.

Konsulenca profesionale tekniko-ekonomike ushtrohet për:

- a) Drejtimin e veprimtarive të sipërmarrjeve dhe agjencive të transportit rrugor për udhëtarë dhe mallra;
- b) Ekspertizë në njohjen dhe zbatimin e legjislacionit të trafikut rrugor, sigurisë së qarkullimit të mjeteve në rrugë si dhe të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushat e transportit rrugor.
- c) Përcaktimin e kërkesave tekniko-ekonomike në blerjen e makinerive dhe pajisjeve për sektorë të ndryshëm të transportit.
- d) Ekspertizë për llogaritjen e kostove operacionale dhe optimumeve ekonomike në operacionet e transportit të brendshëm dhe ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave.
- e) Ekspertizë në vlerësimin e dëmeve materiale që shkakton një mjet motorik në rrugë.
- f) Këshillimin, asistencën në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar për operim në transport.

Subjekti mund të aplikojë për një ose më shumë nga fushat e mësipërme të konsulencës, të cilat shënohen edhe në licencë.

Personi fizik ose, kur aplikanti është person juridik, pronari/pronarët, administratori ose drejtuesi i veprimtarisë, duhet të ketë mbaruar arsimin e lartë si inxhinier mekanik ose ekonomist, si dhe të ketë një eksperiencë trevjeçare në fushën e transportit rrugor.

Veprimtaria sipas shkronjës (e) jepet vetëm për profesionin e inxhinierit mekanik.

Subjekti paraqet formularin e autodeklarimit, si dhe:

- a) Curriculum Vitae (CV) të detajuar të tij.
- b) Dokumente për vërtetimin e kualifikimeve dhe specializimeve të kryera.
- c) Dokumente që vërtetojnë eksperiencën në punë për fushat e veprimtarisë ku aplikon (libreza e punës ose vërtetim nga organet ku punon ose ka punuar, si dhe për specialitetin ku ka punuar).
- d) Diplomën e mbarimit të shkollës së lartë.

Për rinovim të licencës subjekti paraqet dokumentin sipas pikës 1 të nenit 16.

KREU VII
DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

Neni 40

1. Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, të marrë masat e duhura për nxjerrjen e dokumenteve përkatëse për pikën 3 të nenit 8; shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 8; shkronjën “a” të nenit 31 dhe shkronjën “b” të nenit 37, brenda 90 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.
 2. Anekset 1 ÷ 4 bashkëngjitur janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.
 3. Udhëzimi i Ministrit nr.5781, datë 23.12.2003 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së licencave, lejeve, certifikatave dhe autorizimeve për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” siç është ndryshuar, shfuqizohet.
 4. Licencat e dhëna sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit nr.5781, datë 23.12.2003 do të vazhdojnë të jenë në fuqi brenda afatit të tyre të vlefshmërisë.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

ANEKSI 1
TRANSPORTI I LIBERALIZUAR I MALLRAVE

Në marrëveshjen e vendeve anëtare të ECMT/CEMT janë përjashtuar nga kërkesat për leje transporti bilaterale ose multilaterale kategoritë e mëposhtme të transportit:

1. Transporti i mallrave me mjete rrugore me motor pesha e përgjithshme e lejueshme me ngarkesë e të cilit, duke përfshirë dhe rimorkiot, nuk i kalon 6 tonë, ose kur ngarkesa e dobishme e lejuar, përfshirë rimorkiot, nuk i kalon 3.5 tonë (e pavlefshme për Austrinë, Finlandën dhe Italinë).
 2. Transporti i rastësishëm i mallrave për dhe nga aeroporti në rastet kur shërbimet transferohen nga një lloj transporti në tjetrin, (e pavlefshme për Gjermaninë).
 3. Transporti i mjeteve rrugore që janë dëmtuar ose defektuar dhe lëvizja e mjetit të defektuar pas riparimit.
 4. Vajtja pa ngarkesë e mjeteve të transportit të mallrave, të dërguara për të zëvendësuar një mjet të defektuar në një vend tjetër, dhe gjithashtu kthimi, pas riparimit, i mjetit të defektuar.
 5. Transporti i gjësë së gjallë me mjete të konstruktura, ose të konvertuara në mënyrë permanente, për transportin e gjësë së gjallë dhe të njohura si të tilla nga autoritetet kompetente të një vendi anëtar të ECMT/CEMT, (e pavlefshme për Austrinë, Republikën Çeke, Estonin, Francën, Gjermaninë, Hungarinë, Italinë, Poloninë, Federatën Ruse dhe Zvicrën).
 6. Transporti i pjesëve të këmbimit dhe furnizimet për anijet dhe avionët ndëroqeanikë, (e pavlefshme për Federatën Ruse dhe Republikën Çeke).
 7. Transporti i furnizimeve dhe aparaturave mjekësore që nevojiten për emergjenca, në veçanti për katastrofa natyrale dhe nevoja humanitare.
 8. Transporti jo për qëllime tregtare i punimeve dhe objekteve të artit për ekspozita dhe panaiere.
 9. Transporti për qëllime jotregtare të pasurive, pajisjeve dhe kafshëve për dhe nga aktivitetet teatrale, muzikore, filmike, sporteve ose cirk, panaiereve ose konkurseve, ose për prodhime filmi ose televizioni.
 10. Transporti i mallrave për llogari të vet, (e pavlefshme për Austri, Bjellorusi, Republika Çeke, Estoni, Finlandë, Francë, Hungari, Itali, Lituan, Poloni, Portugali, Federata Ruse, Suedi dhe Turqi).
 11. Transporti i funeraleve.
 12. Transporti postar i transportuar si shërbim publik, (e pavlefshme për Itali, Austri).
 13. Transferimi ose marrja përsëri e mjeteve pa ngarkesë në destinacionin e fundit.
- Në marrëveshjet bilaterale të transportit ndërkombëtar rrugor, ku Republika e Shqipërisë është

palë, përcaktohen edhe transporte të tjera të liberalizuara mallrash, por që janë të vlefshme vetëm me shtetin, që është palë në marrëveshje.

ANEKSI 2
LLOJET E MJETEVE DHE MALLRAVE QË NUK KANË NEVOJË PËR LICENCË
OSE CERTIFIKATË

(Sipas udhëzimit nr.1648, datë 16.8 1999 të ministrisë)

1. Llojet e mjeteve, me qira dhe për të tretë, për të cilat nuk do të kërkohet licencë përfshihen mjetet e:

- Sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes, të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Drejtësisë.

- Kryqit të Kuq, dhe ato mjete që transportojnë ndihma ushqimore e mjekësore në rastet e fatkeqësive natyrore.

- Që transportojnë mallrat e rastit për ose nga aeroportet.

- Transportit të kafshëve të gjalla me kamiona të specializuar për këtë qëllim.

- Që transportojnë pjesë këmbimi për mjetet e defektuara në rrugë, për anije ose për aeroplanë.

- Që shkojnë për të zëvendësuar një mjet të defektuar në rrugë.

- Që transportojnë objekte ose materiale për shfaqje teatrale, sportive, cirku, për regjistrime në radio, në televizion dhe për prodhime filmike.

- Shërbimeve funerale.

- Shërbimeve bankare.

- Shërbimeve komunale.

- Transportit të ujit të pijshëm.

- Autoriteteve lokale për mbrojtjen civile (MCR), të policisë, zjarrfikësve, autoambulancat, avaro-shpëtuese të minierave.

- Urgjencës së elektrikut, ujit të pijshëm, telekomit, të aeroporteve brenda tyre.

- Të provës nga prodhuesi, autoshkollave.

- Pastrimit të borës dhe shpërndarjes së kripës, së rërës në rrugë.

- Që lëvizin të pajisur me mekanizma ngarkim-shkarkimi, trajlera ose rimorkio që nuk shërbejnë për transport mallrash, por që lidhen me konstruksionin e mjeteve për mirëmbajtjen e rrugëve, rulat rrugore dhe rimorkiot e tyre.

2. Në llojet e mallrave për transport brenda vendit, që nuk kanë nevojë për certifikatë përfshihen:

- Mallrat që transportohen me mjete që përfshihen në pikën 1 të këtij aneksi, kur ato punojnë për llogari të vet.

- Transporti i mbeturinave që dalin nga pastrimi i qyteteve dhe shërbimeve të tjera publike në qytete.

- Çimento rifuxho nga fabrika për në objektet e ndërtimit.

- Furnizimi i njësive tregtare me vezë, peshk i freskët, perime të freskëta, qumësht e prodhime të tij, kur ato ndodhen brenda qytetit.

- Furnizimi i farmacive ose spitaleve me barna mjekësore brenda qytetit.

- Transporti i postës, kur mjetet janë pronë e Drejtorisë së Përgjithshme të Postave.

- Transporti i prodhimeve nga fermat bujqësore e blegtorale për në fabrikat e përpunimit.

- Transporti i orendive, mobilieve dhe sendeve të tjera shtëpiake, si dhe orendi e pajisje zyrash.

- Transporti i sendeve apo lëndëve të konsumit publik si libra, pajisje shkollash, spitalesh apo qendra shëndetësore, apo qendra kërkimore shkencore.

- Transporti i sendeve dhe lëndëve të forcave të armatosura.

- Në të gjitha rastet e mësipërme, subjekti pronar i mjetit, vërteton me dokumente zyrtare të lëshuara prej tij llojin e destinacionin e mallrave, me përjashtim të Forcave të Armatosura.

Kur mallrat e mësipërme transportohen për llogari të subjektit me mjete jo në pronësi të tij, mjetet e transportuesit që ofron shërbimin me pagesë duhet të jenë pajisur me certifikatë, sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

ANEKSI 3

Datë, më _____

FORMULARI TIP I AUTODEKLARIMIT

(drejtuar autoritetit kompetent ku bëhet aplikimi)

I.

Unë i nënshkruari _____ administrator/pronar/drejtues i veprimtarisë së shoqërisë (*) _____ me seli në _____ deklaroj që jam banues në adresë _____ tel. _____ cel. _____ dhe me dokument identifikimi/ nr. pasaportës _____

Deklaroj që shoqëria _____ e regjistruar në organet tatimore me nr. NIPT-i (**) _____, me vendim gjykatë nr. _____, datë _____, ndryshuar me nr. _____, datë _____, me objekt veprimtarie aktiviteti për të cilin kërkoj të licencohem; nuk është në proces falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj të tretëve (Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve, Organeve të Pushtetit Vendor).

Deklaroj që nuk jam në proces hetimi dhe as në proces gjyqësor, nuk jam shpallur fajtor për shkelje të ligjit të punës, legjislacionit të transportit dhe në veçanti për shkelje të rregullave lidhur me kohën e drejtimit dhe pushimit për drejtuesin e mjetit.

Deklaroj që njoh dhe zbatoj ligjin nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” dhe ndryshimet e tij, udhëzimin nr. _____ datë _____ “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave/ autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”.

II.

Lloji i aktivitetit për të cilin aplikohet: _____

Kërkoj të pajisem me licencë/ autorizim/certifikatë: _____

Deklaroj që për ushtrimin e aktivitetit të mësipërm zotëroj në pronësi ose me qira automjetet me targat e mëposhtme: (kur kërkohet në veprimtarinë që aplikohet)

në pronësi / me qira		në pronësi / me qira	
1. Targa _____	☐	4. _____	☐
2. _____	☐	5. _____	☐
3. _____	☐	6. _____	☐

Keni licencë/autorizim/certifikatë të mëparshme? _____	☐	☐	
Nëse po, specifikoni fushat	1. _____	Nr. _____	datë _____
	2. _____	Nr. _____	datë _____
	3. _____	Nr. _____	datë _____

Keni dëshmi aftësie/ kualifikimi ? _____	☐	☐	
Nëse po, specifikoni llojin _____	Nr. _____	datë _____	

Në shërbimin taksi dëshmia e aftësisë profesionale e taksistit.

Në transportin e mallrave të rrezikshme dëshmia e kualifikimit për drejtuesin e mjetit (ADR).

Në rinovimin e licencës:

Deklaroj që plotësoj kushtin e kompetencës profesionale të paraqitur në licencimin për herë të parë.

III.

Deklaroj në përgjegjësinë time të plotë se :

Të gjitha deklaratimet e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Jam në dijeni që në rast se dokumentet për marrjen apo për të rinovuar licencën/autorizimin dhe/ose certifikatën nuk dorëzohen _____ ditë brenda afatit të përcaktuar, unë humbas të drejtën e marrjes së licencës/autorizimit/certifikatës.

DEKLARUESI

(emër, mbiemër, firmë, vulë) (***)

* Kur aplikanti është një person fizik, formulari i autodeklarimit plotësohet nga vetë personi.

Kur aplikanti është person juridik, formulari i autodeklarimit plotësohet nga personi ose personat (administratori, pronari/pronarët) që drejtojnë efektivisht aktivitetin e transportit të ndërmarrjes. Kur aplikanti është një person që nuk përmbush kërkesat e kompetencës profesionale kjo deklaratë plotësohet edhe për drejtuesin e veprimtarisë i cili plotëson këtë kërkesë.

**Nuk plotësohet në aplikim për herë të parë.

*** Firmosen të gjitha fletët e formularit.

ANEKSI 4 PASQYRA E LËNDËS

KREU I	DISPOZITA TE PËRGJITHSHME
Neni 1	Qëllimi
Neni 2	Përkufizime
KREU II	PRANIMI NË TREG DHE KOMPETENCA NË LICENCIM
Neni 3	Pranimi në treg
Neni 4	Transportet e liberalizuara të mallrave
Neni 5	Llojet e mjeteve dhe mallrave që nuk kanë nevojë për licencim/certifikim
Neni 6	Autoriteti kompetent për lëshimin e liqen/Autoriz./certifikatës
Neni 7	Mbi lejet në marrëveshjet ndërkombëtare.
KREU III	KRITERET BAZË TË LICENCIMIT
Neni 8	Kriteret e licencimit
Neni 9	Lëshimi, refuzimi dhe heqja e Licen/Autoriz/Certifik.
Neni 10	Pavlefshmëria dhe zëvendësimi i Licen/Autoriz/Certifik.
Neni 11	Afatet e vlefshmërisë
KREU IV	FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËR DHËNIEN LIC/AUTORIZ./CERTIF
Neni 12	Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave
Neni 13	Ruajtja dhe arkivimi
Neni 14	Komunikimi me subjektet
KREU V	KËRKESA TE PËRGJITHSHME
Neni 15	Aplikim për herë të parë
Neni 16	Aplikim për përsëritjen e veprimtarisë
KREU VI	KËRKESA TE VEÇANTA
Neni 17	TRANSPORTI RRUGOR I UDHËTARËVE BRENDA VENDIT 1. Autorizimi i Bashkisë për linjat ndërqytetëse 2. Konfirmimi i autorizimit 3. Vërtetimi orareve të kthimit nga Bashkia pikës fundore.
Neni 18	Transporti qytetës
Neni 19	Transporti rrethqytetës
Neni 20	Transporti ndërqytetës
Neni 21	Transporti me taksi
Neni 22	Agjenci për transport udhëtarësh e shërbimi taksi
Neni 23	Transportet e rastit të udhëtarëve brenda vendit TRANSPORT NDËRKOMBËTAR UDHËTARËSH ME AUTOBUS
Neni 24	Transport ndërkombëtar udhëtarësh
Neni 25	Autorizim në linje të rregullt ndërk. udhëtarësh /specilizuar/lavjerrës
Neni 26	Leje operimi (autorizim) për subjektet e huaja
Neni 27	Libër udhëtimi/Leje transporti (autorizim) për shërbimet e rastit.
Neni 28	Agjenci ndërkombëtar transport udhëtarësh TRANSPORT RRUGOR MALLRA BRENDA VENDIT
Neni 29	Transporti i mallrave për të tretë dhe me qira.

Neni 30	Transporti i mallrave për llogari të vet.
Neni 31	Transporti i mallrave të rrezikshme.
Neni 32	Transporti i mallrave me mjete jashtë norme.
	TRANSPORT NDËRKOMBËTAR RRUGOR MALLRASH
Neni 33	Transport i mallrave për te trete dhe me qira
Neni 34	Transporti i mallrave për llogari të vet.
Neni 35	Transporti i mallrave të rrezikshme.
Neni 36	Rinovimi i certifikatës së automjeteve (udhët., mallra)
Neni 37	Transport ndërkombëtar multilateral CEMT.
Neni 38	Agjenci spedicionere
Neni 39	Konsulencë tekniko-ekonomike
KREU VII	DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT
Neni 40	

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3. REGJISTRAT E NOTERISË	
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
i. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
ii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
iii. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
iv. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
v. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
vi. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
vii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

TREGUES LEGJISLACIONI

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500

Hyri në shtyp më 7.8.2007
 Doli nga shtypi më 9.8.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
 Tiranë, 2007

Çmimi 48 lekë